



QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE
Regjistruar me vendimin nr.8/1, dt.14.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Tiranë
TEL.04 2259795 FAX.04 2241914
P.O.BOX1549 E- MAIL: avokatore@albmail.com

R A P O R T

Titulli: **Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit shqiptar, në luftë kundër trafikimit të qënieve njerëzore me fokus në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore.**

Analizë e legjislacionit dhe praktikës shqiptare mbi trafikimin e qënieve njerëzore, duke përfshirë asistencën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore dhe monitorimin e gjykatave.

Ky raport është përgatitur në kuadrin e projektit “Edukimi Ligjor dhe Mbrojtja e të Drejtave.”

Tiranë, 2009

Financuar nga OSBE/ODIHR

Ky raport realizohet në kuadër të projektit “Edukimi ligjor dhe Mbrojtja e të Drejtave. Aksesi në Drejtësi i personave të trafikuar dhe grupeve në rrezik për tu trafikuar”, mbështetur nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut/Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE/ODIHR.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron qëndrimin e donatorëve.

Koordinatorë projekti : Av. Aurela Bozo
Drejtuuese shkencore: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi

E drejta e autorit: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Raporti u përgatit nga ekspertët: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi
Av. Besa Saraçi
Av. Aurela Bozo

Falenderojmë në mënyrë të veçantë për ndihmën e dhënë Znj. Allison Jernow, Eksperte e Pavarur mbi Trafikimin dhe Drejtësinë penale dhe Astrid Ganterer, Programi Anti-Trafikim, ODIHR.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni me ne, në adresën e mëposhtme:

“Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”-QNLQ, (ish-Qendra Avokatore për Gratë-QAG)





Adresa: Rr. ”Vaso Pasha”, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë-Shqipëri

Tel.00355 4 2 259795, 00355 4 2 241914, Fax: 00 355 42 241914; ose vizitoni faqen tonë

të internetit: www.qag-al.org

STRUKTURA E RAPORTIT

HYRJE, OBJEKTI I STUDIMIT DHE METODOLOGJIA E TIJ

-  Hyrje
-  Objekti i Studimit
-  Qëllimi i studimit
-  Metoda e studimit

KREU I TE DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE.

- 1.1 Një vështrim i përgjithshëm.
- 1.2 E drejta ndërkombëtare për të drejtën për informim të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
- 1.3 E drejta ndërkombëtare për të drejtën për këshillim dhe asistencë ligjore e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
- 1.4 E drejta e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për siguri, mbrojtje dhe rehabilitim në të drejtën ndërkombëtare.
- 1.5 E drejta ndërkombëtare për kompensimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

KREU II NJË ANALIZË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

- 2.1 Kushtetuta e RSH-së
- 2.2 Ligjet
- 2.3 Aktet nënligjore

KREU III TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PRAKTIKË

- 3.1 E drejta për informim e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
- 3.2 E drejta për ndihmë ligjore e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore..

- 3.3 E drejta për mbrojtje / siguria fizike e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
- 3.4 E drejta për kompensim e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
- 3.5 Disa të dhëna nga monitorimi i vendimeve penale të formës së prere, për vitet 2004 -2007, në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

KREU IV ÇËSHTJE TË KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- 4.1. Zhvillimet e legjislacionit Shqiptar për kompensimin.
- 4.2 Mekanizmat e parashikuara nga ligji shqiptar për kompensimin e viktimave të trafikimit.
- 4.3 Kërkimi i dëmit material në procesin penal.
- 4.4 Skema shtetërore e kompensimit të viktimave të trafikimit.
- 4.5 Konkluzione dhe sygjerime.

KREU V PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

- 5.1 Legjislacioni dhe përmirësimi i tij.
- 5.2 Procesi gjyqësor dhe praktika e ndjekjes penale.
- 5.3 Roli i Organizatave Jofitimprurëse.
- 5.4 Kompensimi dhe rehabilitimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

KREU I

OBJEKTI I STUDIMIT DHE METODOLOGJIA E TIJ

- **Hyrje**

Trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar nga legjislacioni shqiptar, si një veper me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Krijimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda¹, kompetente për gjykimin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore ka bërë më efikase goditjen e këtij fenomeni me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjithashtu, ka patur një angazhim në rritje të të gjitha strukturave shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përmes masave parandaluese dhe mbrojtëse, si të natyrës ligjore, ashtu edhe të tipit administrativ, social, ekonomik, etj.

Legjislacioni shqiptar ka evoluar në përfaqje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH. Strukturat përgjegjëse kanë mëshuar në zbatimin e Strategjisë së luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe janë krijuar mekanizma që mundësojnë realizimin e saj. Njësia Anti-Trafikim, e ngritur posaçërisht për këtë qëllim, e ka thelluar punën e saj në koordinim me policinë e Kufirit, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, organizatat jofitimprurëse dhe me aktorë të tjerë. Me një urdhër të përbashkët² të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, është ngritur Autoriteti Përgjegjës, për garantimin e mbrojtjes dhe ndihmës ndaj viktimave, si dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Kjo do të realizohet përmes bashkërendimit dhe monitorimit të procesit të referimit, për ndihmën, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre. Gjithashtu, një strukturë të rëndësishme në adresimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore përbën edhe Koordinatorja Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, pranë Ministrisë së Brendshme.

Këto struktura po bashkërendojnë punën edhe me Organizatat Ndërkombëtare, duke synuar për zbatimin e Mekanizmave Transnacionalë të Referimit për personat e trafikuar në Europën Juglindore, dhe zbatimin e këtyre mekanizmave në nivel kombëtar.

- **Objekti i Studimit**

Në të gjithë qasjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, çështja e zbatimit me efikasitet të ligjit dhe përmirësimi i praktikave të organeve të drejtësisë, përbëjnë një faktor vendimtar. Pikërisht, ndihmesa në këtë aspekt ka qenë qëllimi i monitorimit dhe analizës që Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, ka kryer për një periudhë 1-vjeçare dhe po e paraqet përmes këtij raporti.

Duke qenë të ndërgjegjshëm, se trafikimi është një dukuri shumë komplekse që e skllavëron viktimën dhe e bën atë të paaftë për të përballuar jetën, menduam që analiza e masave ligjore, administrative, praktikave gjyqësore dhe politikave shtetërore të shihet

¹ Krijuar me ligjin nr.9110, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda”.

² Ky urdhër është miratuar nga Ministria e Brendshme me nr.3394/4, datë 17.05.2006, nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.1152, datë 19.05.2006 dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme me nr.7590, datë 24.05.2006.

nga një këndvështrim i ri dhe konkretisht, përmes garantimit të të drejtave të viktimave të trafikut, në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në mënyrë të veçantë, ky studim synon të analizojë rezultatet që ka sjellë zhvillimi dhe përmirësimi i legjislacionit që lidhet me trafikimin e qënieve njerëzore, si dhe zbatimi i tij, nëpërmjet praktikave hetimore dhe gjyqësore për këto vepra.

Së pari, studimi ka si objekt monitorimin e vendimeve të gjykatave dhe të praktikave të organeve të drejtësisë, në lidhje me këto vepra, për periudhën 2004-2007. Ai vjen në vijim të studimeve të mëparshme të kryera nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore për vitet 2000-2003 dhe sjell disa risi në analizën e kryer dhe në konkluzionet e rekomandimet.

Së dyti, studimi zgjeron rrethin e gjykatave të monitoruara duke përfshirë Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë.

Së treti: në studim paraqiten gjetje të rëndësishme në lidhje me statusin e viktimës dhe personin e dëmtuar.

Së katërti, ky studim e zgjeron rrethin e veprave të monitoruara. Ai është mbështetur në monitorimin e praktikave në lidhje veprat penale të parashikuara nga Kodi penal, shqyrtimi i të cilave është në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, sikurse vijojnë:³

“Trafikimi i personave” (neni 110/a);

“Trafikimi i femrave” (neni 114/b);

“Trafikim i i të miturve” (neni 128/b),

Përveç sa më sipër, duke konsideruar disa vepra të tjera penale të lidhura me trafikimin si të vlefshme për analizën e zbatimit në praktikë të legjislacionit, studimi përfshin edhe veprat që vijojnë:

“Shitblerja e transplanteve” (neni 89/a);

“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur të moshës 14-18 vjec” (neni 101);

“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” (neni 102);

“Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” (neni 109);

“Braktisja e fëmijëve të mitur” (neni 124); “Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës” (neni 128/a);

“Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë” (neni 130);

“Shfrytëzimi i prostitucionit” (neni 114);

“Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” (neni 114/a);

“Mbajtja e lokaleve për prostitucion” (neni 115);

“Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” (neni 297);

“Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit” (neni 298).

³ Neni 75(a) i Kodit të Procedurës Penale

- **Qëllimi i studimit**

Ky studim do të kontribuojë për një akses më të madh të viktimave të trafikimit përmes njohjes dhe gëzimit të të drejtave të tyre ligjore. Rekomandimet dhe sygjerimet e dala nga ky studim do të shërbejnë për një përmirësim të veprimtarisë së organeve të drejtësisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës në vendin tonë.

- **Metoda e studimit**

Metodologjia e përdorur në këtë raport është e larmishme. Ajo përfshin analizën e standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve kombëtare, monitorimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e përzgjedhura, asistencën e drejtëpërdrejtë për viktimat dhe konsultime me aktorë të ndryshëm që punojnë për adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Nga pikëpamja teknike, u përdor metoda e monitorimit të vendimeve të Gjykatës së Krimeve të Rënda në lidhje me veprat penale të sipërpërmendura. Ky monitorim u mundësua përmes bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë me Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë dhe, monitorimit të publikimeve në faqen përkatëse të internetit të Gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. Gjithashtu, u monitoruan disa seanca gjyqësore në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Gjetjet e prezantuara në këtë raport ngrihen mbi të dhënat e mbledhura nëpërmjet një skede monitoruese, e cila u hartua nga ekspertët duke përfshirë tregues që vijojnë:

- ✚ Të dhëna në lidhje me viktimën përsa i përket mënyrës së deklarimit të dëshmisë prej saj, në gjykatë.
- ✚ Të dhëna në lidhje me problematikat sociale, me të cilat viktimat është përballur dhe e kanë bërë atë vulnerable ndaj fenomenit të trafikimit ose veprave të tjera të përafërta me të.
- ✚ Të dhëna në lidhje me formën e shfrytëzimit të viktimës
- ✚ Të dhëna në lidhje me përdorimin nga viktimat të së drejtës së saj për ngritjen e padisë civile në procesin penal
- ✚ Të dhëna në lidhje me gjendjen e të gjykuarit
- ✚ Referimi i gjyqtarit në aktet ndërkombëtare, në lidhje me të drejtat e viktimës së trafikimit

Treguesit e skedarëve të plotësuar u integruan në një bankë të dhënash dhe u përpunuan nga pikëpamja sasiore–statistikore, duke u analizuar nga ekspertët ligjorë. Analizat, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij studimi u diskutuan dhe u tërhoqën mendimet e profesionistëve të sistemit të drejtësisë, si dhe avokatëve pranë organizatave jofitimprurëse, të cilat adresojnë problemin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Një metodë specifike e përdorur është edhe ajo e vetëpërfshirjes, gjë që nënkupton analizimin e rasteve, për të cilat është dhënë mbështetje ligjore nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ndaj viktimave të trafikimit dhe personave në rrisht për tu trafikuar. Ka shërbyer në plotësimin e studimit dhe nxjerrjen e konkluzioneve, evidentimi i

problematikave të evidentuara nga monitorimi i seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me trafikimin dhe veprat e përafërta me të.

Pjesë e rëndësishme e këtij studimi ka qenë edhe analiza e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar në lidhje me parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit, detyrimet që burojnë nga këto akte ndërkombëtare për shtetin shqiptar, evolucioni i legjislacionit tonë të brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare, situata faktike dhe nevoja për përmirësime. Studimi i përjasjes së legjislacionit dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, kanë ndihmuar në analizën krahasimore dhe në nxjerrjen e problemeve e rekomandimeve. Përfundimet e arritura dhe rekomandimet përkatëse kanë shoqëruar gjithë materialin dhe janë ndërthurur sipas problematikave në çdo kre.

Eksperiencia e avokatëve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare në monitorimin dhe analizën e aktivitetit të organeve të drejtësisë përmes monitorimit të vendimeve dhe seancave gjyqësore, në lidhje me çështje të trafikimit, dhunës në familje, korrupsionit në organet e drejtësisë, ka përbërë një garanci për cilësinë e këtij studimi.

Raportet e përgatitura nga organizata të tjera kombëtare shqiptare, raportet e organizatave ndërkombëtare, si dhe ato të përgatitur nga institucione të ndryshme shtetërore, kanë përbërë një pikë referimi për studimin dhe kanë ndihmuar në cilësinë e tij.⁴

KREU I

TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

1.1 NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM⁵.

Mekanizmi kushtetues shtron nevojën e përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare, me qëllim që ato të jenë pjesë e legjislacionit, i cili nuk mund të jetë në kundërshtim me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe Bashkimit European.

Njohja me standartet e Bashkimit European dhe legjislacionin në këtë fushë përbëjnë një aspekt të rëndësishëm, sepse është ratifikuar dhe është në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocjimit me Bashkimin European, e cila është detyruese për Shqipërinë. Kjo Marrëveshje parashikon detyrimin e Shqipërisë të sigurojë që legjislacioni ekzistues shqiptar të jetë i përafërta me atë të Komunitetit European. Shqipëria do të përpiqet të

⁴ *Njesia Antitrafik, Ministria e Brendshme*, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”; raporti i OSBE-ODHIR-it (Barcelonë 2007) për Shqipërinë, etj.

⁵ Për përgatitjen e kreu I jemi konsultuar me prezantimet e Znj. Allison Jernow, Eksperte e Pavarur mbi Trafikimin dhe Drejtësinë penale, në trajnimet me gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore organizuar nga QNL në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit 2008-2009, me mbështetjen e OSBE/ODIHR.

sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe ai i ardhshëm të përqaset gradualisht me *acquis* komunitare. (neni 70)⁶

Gjithashtu, Marrëveshja përcakton detyrimin për të bashkëpunuar në fushën penale, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. (neni 85)

Lëvizja e viktimave të veprave penale në Europë dhe në Amerikën e Veriut reflektoi nga pikëpamja morale nevojën për njohjen e dëmit që u shkaktohet viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga autori i veprës penale dhe nga pikëpamja funksionale kjo lëvizje shprehu nevojën për të rritur pjesëmarrjen e viktimës në proceset penale.

Me qëllim që të rritet pjesëmarrja e viktimave në proceset penale nevojitet jo vetëm njohja me ligj i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore por edhe garantimi në praktikë i këtyre të drejtave. E drejta ndërkombëtare i kushton një rëndësi të vecantë këtyre të drejtave dhe kërkon nga Shtetet Palë garantimin e tyre përmes masave dhe politikave gjithëpërfshirëse.

Por cilat janë disa nga të drejtat kryesore të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në të drejtën ndërkombëtare? *E drejta për informim, e drejta për asistencë ligjore, e drejta për mbrojtje, dhe e drejta për kompensim janë disa nga këto të drejta.*

Dokumente të një rëndësie të vecantë ndonëse përbëjnë të drejtën e butë datojnë prej vitit 1980. Në vitin 1985, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin (85) 11 “Mbi Pozicionin e Viktimës në Kuadrin e të Drejtës dhe Procedurës Penale”. Drejtësia penale ka një “Funksion kyç”, ajo duhet të plotësojë nevojat dhe të mbrojë interesat e viktimës. Ky funksion është i lidhur drejtpërdrejtë me rritjen e besimit të viktimave në sistemin e drejtësisë penale dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre si dëshmitarë në këtë sistem.

Informimi i viktimave nga policia rreth mundësive të marrjes së ndihmës, këshillave praktike dhe ligjore, kompensimit nga autori i veprës penale, dëmshpërblimit shtetëror dhe ofrimit të sigurisë për to; informimi i viktimave rreth vendimit përfundimtar që lidhet me ndjekjen penale; informimi i viktimave mbi datën dhe vendin e proceseve gjyqësore; mundësitë e viktimave për kompensim dhe informimi i tyre mbi rezultatin e çështjes; informimi i viktimave mbi urdhrin e kompensimit të autorit të veprës penale si pjesë e sanksionit penal; asistenca ofruar viktimave në marrjen e dëmshpërblimit; janë çështje të tjera të një rëndësie të vecantë tek të cilat vë theksin ky rekomandim.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm në lidhje me të drejtat e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është Rekomandimi nr (2006) 8, “Mbi asistencën për viktimat e krimin”.

Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale, në Nenin 9 të tij parashikon detyrimin e shteteve që :

⁶ www.mie.gov.al, Marrëveshja e Stabilizimit Asocjimit midis Komunitetit European dhe Shteteve Anëtare të tij nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër.

-të sigurohen që viktimat të marrin një vendim brenda afateve të arsyeshme kohore për dëmshpërblimin nga pala e paditur si edhe të marrin masat e nevojshme për të inkurajuar palen e paditur për të ofruar dëmshpërblimin e duhur për viktimat.

Në 1985 u miratua Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimit të Kompetencave. Ndonëse përbëjnë instrumente jodetyruese, shumë prej rekomandimeve janë shëndërruar tashmë në instrumente detyruese. Deklarata e Kombeve të Bashkuara “për Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimit të Kompetencave” përkufizon viktimën si një person të dëmtuar, duke përfshirë dhe dëmet fizike ose mendore, vuajtjet emocionale, humbjet ekonomike ose dëmtimin thelbësor të të drejtave themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me të drejtën e brendshme penale.

Në kushtet e mungesës së përkufizimit të “viktimës” në legjislacionin shqiptar ne mund ti referohemi kësaj dispozite. Personi i dëmtuar mund të konsiderohet viktimë pavarësisht nëse është identifikuar, kapur, ndjekur ose dënuar autori i veprës.

Disa nga parimet bazë të kësaj Deklarate janë aksesin në drejtësi dhe trajtimi i drejtë; Kthimi (nga pala e akuzuar); Kompensimi (nga shteti), kur nuk është plotësisht i mundur të dëmshpërblehet nga autori i veprës penale dhe inkurajimi i krijimit të fondeve kombëtare; Ndihma për viktimat.

Shteti shqiptar, është angazhuar në mënyrë të veçantë, me parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, duke shpehur vullnetin e tij në luftën kundër këtij fenomeni edhe nëpërmjet ratifikimit të disa konventave ⁷, të cilat zënë një vend të vecantë⁸ në hierarkinë e akteve ligjore.

Njohja dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i konventave, përbën një sfidë për profesionistët e e përfshirë në aktivitetin anti trafikim, në mënyrë të vecantë në lidhje me sigurimin e aksesit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në të drejtat e tyre. Në rastet kur

⁷ Konventa ndërkombëtare për ndalimin e trafikut të grave dhe fëmijëve, përfunduar në Gjenevë, më 1921 dhe protokollin amendues i saj.

- Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshë madhore, përfunduar në Gjenevë më 1933 dhe protokollin amendues i saj.

- Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve dhe protokollin final i saj në 1950.

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.

- Protokoll “Kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

- Protokollin “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW, 1979, ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 09.11.1993.

-Konventa Europiane “Për Kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr.9265, datë 29.07.2004.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 122, “ 1.Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.....2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.....”

konventat e ratifikuara nga shteti shqiptar përfshijnë dispozita të një karakteri të përgjithshëm, Shteti shqiptar detyrohet të hartojë ligje kombëtare në përputhje me to.

Miratimi i ligjeve dhe i akteve normative sipas standardeve të përfshira në aktet e ndryshme ndërkombëtare në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian, ka qenë përparësi e legjislativit dhe ekzekutivit shqiptar dhe ka përbërë një bazë të qëndrueshme për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Detyrimet dhe **rekomandimet që burojnë nga aktet ndërkombëtare** kanë përbërë një burim nxitjeje për evoluimin e legjislacionit të brendshëm, në përputhje me standardet e parandalimit dhe goditjes së trafikimit të qënieve njerëzore.⁹ Zhvillimet më të reja në legjislacionin tonë penal¹⁰ janë kryer në përqsasje me këto akte ndërkombëtare detyruese dhe jo detyruese.

Një detyrim i qenësishëm, që buron nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga shteti shqiptar konsiston në përmirësimin e statusit të viktimës dhe ofrimin e asistencës për viktimat e trafikut të personave, duke nënvizuar se, fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore mund të parandalohet dhe goditet me efektivitet, vetëm kur në qendër të masave që merren është viktimja. Këto detyrime përfshijnë jo vetëm marrjen e masave legislative ose/dhe administrative që u sigurojnë viktimave informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative, por edhe asistencën, lehtësimin dhe pranimin, kthimin e personit të trafikuar pa vonesa të paarësyeshme, garantimin e sigurisë fizike të viktimave të trafikut, si dhe përfshirjen në sistemin ligjor të atyre masave që ju ofrojnë viktimave të trafikimit mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar.

1.2. E DREJTA NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN PËR INFORMIM TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE.

Burimet e të drejtës për informim të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore në të drejtën ndërkombëtare janë: Protokollin e Trafikimit të Kombeve të Bashkuara; Konventa Evropiane për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore; Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale; Parimet Bazë të Drejtësisë për Kombet e Bashkuara; Rekomandimi (2006) 8 i Këshillit të Europës.

Protokollin e Trafikimit të Kombeve të Bashkuara, në nenin 6(2) kërkon nga Shtetet palë të sigurojnë se sistemi i tyre ligjor përmban masa që i pajisin viktimat e trafikimit me “informacionin e duhur për proceset gjyqësore dhe ato administrative” si dhe mbështesin viktimën në shprehjen e shqetësimeve të tyre gjatë procedurave penale.

⁹ Komiteti CEDAW, me rekomandimet e janarit të vitit 2003, rekomandon prezantimin e masave që synojnë të përmirësojnë situatën ekonomike të grave që të eliminojnë vulnerabilitetin e tyre ndaj trafikantëve, nisma arsimimi për grupet vulnerabël, duke përfshirë vajzat adoleshente, dhe mbështetje shoqërore, masa rehabilitimi dhe riintegrimi për gratë dhe vajzat që kanë qenë viktimja të trafikut.

¹⁰ Amendimet e legjislacionit penal me ligjin nr.8733, datë 24.02.01; ligjin nr.9188, datë 12.02.04.

Konventa Evropiane për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në nenin 12, pika d kërkon nga Shtetet Palë të marrin masa për të ofruar ndihmë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, e cila do të konsistojë në “këshillim dhe informacion, në veçanti në lidhje me të drejtat e tyre dhe me shërbimet në dispozicion të tyre, në një gjuhë që është e kuptueshme prej tyre.” Neni 15(1) detyron shtetet të sigurojnë që viktimat kanë akses në informacion në lidhje me procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative, që nga kontakti i parë i tyre me autoritetet kompetente, në një gjuhë që ato mund ta kuptojnë.

Konventa Evropiane mbi Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme në nenin 11 të saj parashikohet se çdo Shtet Palë duhet të ndërmarrë hapa të përshtatshëm për të siguruar që informacioni mbi skemën t’u jepet kërkuesëve të mundshëm.

Neni 4 i **Vendimit Kuadër të BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale** kërkon akses në informacion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nga organizatat që ofrojnë mbështetje për to, në shërbimet që këto organizata ofrojnë, ku dhe si të denoncojnë veprën penale, procedurat që duhet të ndjekin, tu ofrohet këshillim dhe/ose ndihmë ligjore, të informohen në lidhje me të drejtën për kompensim, si edhe të marrin informacion për vendimin e gjykatës.

Informimi i viktimave për proceset penale dhe ecurinë e tyre, shprehja e shqetësimeve dhe mendimeve prej tyre në cdo fazë të procesit përbëjnë **parime Bazë të Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë.**

Rekomandim të Këshillit të Europës (2006) 8 rekomandon sigurimin e aksesit në informacion për viktimat, i cili do të konsistojë në informacion mbi shërbimet, procedurat ligjore dhe rolin e viktimës në këtoprocudura, informacion mbi të drejtën e viktimave për të qenë të mbrojtura dhe për të marrë kompensim nga autori i veprës penale ose nga shteti, ofrimin e këshillimit dhe asistencës ligjore.

Rekomandimi të Këshillit të Europës (85) 11 rekomandon autoritetet që ti japin informacionin përkatës viktimës. Ai parashikon për shembull që policia dhe gjykatat duhet të informojnë viktimat mbi mundësitë e marrjes së asistencës, këshillimit ligjor dhe praktikë dhe kompensimit.

Përmeshja e të drejtës së viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për tu informuar është e lidhur ngushtë me të drejtën për kompensim dhe ushtrimin e të drejtave të tjera. Vetëm nëse viktimat i njeh të drejtat dhe mundësitë e tij/saj brenda sistemit ligjor, ai/ajo mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe mundësi. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë pak informacion mbi mënyrën sesi funksionon sistemi i drejtësisë penale dhe kjo i kufizon viktimat që të përdorin të drejtat e tyre brenda këtij sistemi.

Referimi në këto akte ndërkombëtare u evidentua edhe në praktikën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në vitet 2004-2007, monitoruar nga QNL. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore mbanin parasysh këto akte në zbatimin e të drejtave të viktimës. P.sh., edhe pse ligji procedural shqiptar nuk është shprehur mbi detyrimin e organit për të

informuar viktimën për të gjitha të drejtat, prokurorët e çështjes përpiqeshin ta bënin këtë gjë. Kjo, nuk mund të justifikojë mungesat e dispozitave në ligjin e brendshëm që të parashikojnë detyrimin e organeve përkatëse për informimin eviktimave të trafikimit të qenieve njerëzore si detyrim ligjor.

1.3 E DREJTA NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTËN PËR KËSHILLIM DHE ASISTENCË LIGJORE TË VIKTIMAVE TE TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJERËZORE.

Burimet e së drejtës së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për këshillim ligjor në të drejtën ndërkombëtare janë: Konventa Evropiane e Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Rekomandimi i Këshillit të Europës (2006)8, Vendimi Kuadër i BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale; Parimet Bazë të Drejtësisë të Kombeve të Bashkuara për Viktimat e Krimit; Parimet e rekomanduara të Kombeve të Bashkuara dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore.

Konventa Evropiane për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në nenin 15(2) kërkon nga Shtetet Palë të parashikojnë në të drejtën e brendshme, ofrimin e asistencës ligjore falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, një komponent i rëndësishëm i së cilës është këshillimi ligjor.

Vendimi Kuadër i BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale kërkon që viktimat të kenë akses falas në këshillim, kur është e nevojshme.

Garantimi i kësaj të drejte rekomandohet edhe nga një numër instrumentash politikisht detyrues. Kështu, Rekomandimi i Këshillit të Europës (2006) 8 rekomandon shtetet t'u sigurojnë viktimave akses efektiv ligjor.

Parimet dhe Udhëzimet e rekomanduara nga Kombet e Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Njerëzve kërkojnë garantimin e ofrimit të ndihmës ligjore për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (në një gjuhë që kuptohet prej tyre) në lidhje me çështjet penale, civile ose veprime të tjera kundër autorëve të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Ofrimi i ndihmës së përshtatshme për viktimat, gjatë gjithë procesit ligjor përbën një nga Parimet Bazë të Drejtësisë së Kombeve të Bashkuara.

E drejta e këshillimit ligjor dhe garantimi i saj është shumë e rëndësishme në lidhje me garantimin e të drejtës për kompensim të viktimave. Garantimi i të drejtës për këshillim ligjor mundëson kërkimin e të drejtës për kompensim nga viktimat në mënyrë efektive duke kuptuar edhe kompleksitetin e procedurave të gjykatës.

Në këtë kuadër, një rol shumë të rëndësishëm luan edhe rritja e ndërgjegjësimit për juristët, avokatët dhe stafin e Organizatave Jofitimprurëse. Ndërgjegjësimi i tyre do të ndihmonte që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të merrnin këshillim ligjor dhe të ndërgjegjësoheshin për të paraqitur padi efektive për kompensim.

1.4 E DREJTA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TE QENIEVE NJEREZORE PËR SIGURI, MBROJTJE DHE REHABILITIM NE TE DREJTEN NDERKOMBETARE.

Nenit 6(5) të Protokollit të Trafikimit të Kombeve të Bashkuara dhe Konventa Evropiane për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nenin 28 dhe 30 kërkojnë nga Shtetet palë të garantojnë të drejtën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për siguri dhe mbrojtje. Mangësitë në garantimin e të drejtës së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për siguri dhe mbrojtje i dekurajojnë ato në kërkimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë të drejtën për kompensim dhe për pasojë rezultojnë në mos gëzimin e të drejtave nga viktimat.

Protokolli i Trafikimit të Kombeve të Bashkuara, Neni 6(3)(a)-(d) dhe Konventa Evropiane për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Neni 12, kërkojnë nga Shtetet palë garantimin e kësaj të drejte.

1.5 E DREJTA NDËRKOMBËTARE PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

Aktet ndërkombëtare kanë sanksionuar të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, si një të drejtë të realizueshme përmes pagesës së dëmit nga autorët e këtyre veprave penale, ashtu edhe përmes skemës shtetërore. Standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar gjithashtu, parimin sipas të cilit përfitimet e nxjerra nga trafikantët përmes shfrytëzimit prej tyre të aktiviteteve kriminale, duhet të përdoren për të dëmshpërblyer viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, individualisht, ose kolektivisht. Këto standarde kanë nënvizuar në mënyrë të veçantë interesat e fëmijëve dhe të grave.

E drejta për kompensim e personave të trafikuar është forcuar si rezultat i sanksionimeve të saj në konventat dhe aktet ndërkombëtare që janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kështu, shtetet palë të *konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC) dhe Protokollit kundër trafikimit (2003)*, kanë detyrimin të sigurojnë ekzistencën e së paku, njëres prej procedurave ligjore, me qëllim që personat e trafikuar të kenë akses për kompensimin e tyre. Ato gjithashtu duhet të sigurojnë për viktimën mekanizmin e informimit të saj në lidhje me këtë të drejtë. Sipas kësaj konvente, aksesit për kompensim duhet të njihet edhe jashtë kufijve.

Protokolli “*Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*” (protokolli i Palermos) që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, kërkon nga Shtetet Palë, trajtimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë komplekse, duke adresuar jo vetëm parandalimin dhe luftën ndaj këtij fenomeni, por edhe mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit.¹¹

¹¹ Protokolli “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

Në kuadrin e garantimit të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, Neni 6(6) i Protokollit “*Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*” në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar kërkon nga Shtetet Palë të sigurojnë që sistemet e brendshme ligjore të përfshijnë masa që ofrojnë mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar.

E drejta për dëmshpërblim mund të përmbushet nga autori i veprës penale ose nga shteti. Pavarësisht se në parim është autori i veprës penale që duhet të paguajë dëmshpërblimin, shpesh kjo e drejtë nuk përmbushet prej tij, për shkak të mospërballjes së tij me ligjin, zhdukjes së tij dhe mungesës së mjeteve financiare të autorit të veprës penale.

Konventa e Këshillit të Europës “*Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore*”¹² parashikon disa detyrime të rëndësishme që konsistojnë në sigurimin e aksesit për viktimat ndaj informacionit mbi procedimet e ngjashme gjyqësore dhe administrative, të drejtës për ndihmë ligjore falas për viktimat, të drejtës për kompensim nga autorët e veprës penale, ose nëpërmjet ngritjes nga shteti të një fondi për kompensim me qëllim integrimin e viktimave. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi në 2008-ën.

Neni 15(3) i Konventës Evropiane “*Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore*” kërkon që në të drejtën e brendshme, secila palë, të parashikojë të drejtën e viktimave për t’u dëmshpërblyer nga autori i veprës penale. Kjo konventë parashikon të drejtën për të kërkuar kompensim nga trafikanti, si për dëmin material ashtu edhe për dëmin moral.

Ajo, përcakton gjithashtu, të drejtën për akses të viktimës ndaj një fondi kompensimi shtetëror, një prej modeleve të cilave u sanksionua në Konventën evropiane “*Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme*”. Garantimi i kësaj të drejte kërkon edhe marrjen e masave ose programeve që synojnë arritjen e ndihmës dhe integritit social për viktimat.

Konventa Evropiane “*Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme*” është hapur për nënshkrim që prej 1983-it dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1988. Konventa parashikon se viktimat duhet të dëmshpërblehen nga i gjithë komuniteti për çdo dëmtim që kanë përjetuar. Neni 2 i kësaj Konvente parashikon detyrimin e shtetit për të kontribuar në dëmshpërblimin e viktimave që kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur drejtpërsëdrejti nga një krim i dhunshëm si edhe të personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë.

Ky detyrim i buron shteteve palë në rastet kur kompensimi i viktimave të krimeve të dhunshme nuk mund të jepet nga burime të tjera. Konventa parashikon detyrimin e Shteteve Palë të ndër marrin hapa të përshtatshëm për të siguruar që informacioni mbi skemën e kompensimit t’u ofrohet kërkuesve të mundshëm. Kjo Konventë përcakton minimalisht përmbajtjen e kompensimit në kategoritë: të ardhurat e humbura, shpenzimet mjeksore, të shtrimit në spital dhe shpenzimet e varrimit, si dhe pensionin ushqimor për personat e varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë.

¹² Ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006

Konventa evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, e kufizon kompensimin nga shteti vetëm në dëmet materiale në rastet kur vepra penale ka qenë një krim i qëllimshëm dhune, me pasoja fizike ose mendore për shëndetin. Ka gjithashtu, limite në përcaktim, i cili përfshin nevojën për të qenë një viktimë e llojeve specifike të krimeve, të dhunës dhe llojeve të dëmit.

Direktivë e Këshillit të BE-së që lidhet me Dëmshpërblimin për Viktimat e Krimit

Kjo Direktivë është miratuar më 29 prill 2004. Kjo Direktivë kërkon nga Shtetet Anëtare të përqasin legjislacionin e tyre me Direktivën, me synim krijimin e një sistemi bashkëpunimi për të rritur aksesin e viktimave për dëmshpërblim, në situatat ndërkufitare. Direktiva parashikon se dëmshpërblimi do të paguhet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar, në territorin e vendit ku është kryer krimi.

E drejta për kompensim është mbështetur edhe nga disa marrëveshje politike (ose “e drejta e butë”), midis të cilave më e rëndësishme paraqitet “*Deklarata e parimeve bazë të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit*”, si dhe Rekomandimi i Këshillit të Europës (2006) 8. Rekomandohet që dëmshpërblimi duhet të ofrohet nga shteti për viktimat e krimeve të rënda, të qëllimshme, të dhunshme, duke përfshirë dhe dhunën seksuale; për familjet dhe personat në varësi të viktimave që kanë vdekur si rezultat i krimeve të tilla. Kjo e drejtë duhet të garantohet për të gjitha viktimat e krimeve të kryera në territorin e tyre, pavarësisht nga kombësia e viktimës.

Përveç kërimit të dëmshpërblimit nga trafikanti, viktimat mundet në disa vende (Francë, Mbretëria e Bashkuar, Rumania, SHBA, etj), të kërkojnë gjithashtu kompensim nga fondi shtetëror. Është zakonisht viktimat e krimeve të dhunshme, ose persona dëmtimi i të cilëve është provuar që janë kompensuar përmes këtij fondi. Sisteme të tilla kompensojnë lloje të veçanta të dëmit material (financiar) por ka gjithashtu disa shtete (Francë, Mbretëria e Bashkuar) në të cilat kompensimi mund të kërkojë gjithashtu për lloje të tjera të dëmtimeve, si psh “dhimbja dhe vuajtja”.

Këto mekanizma janë të drejtëpërdrejta dhe sigurojnë që kompensimi ju është paguar viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar ka Organizata Jofitimprurëse me eksperiencë në këtë fushë, të cilat asistojnë viktimat që të paraqesin kërkesa për kompensim nga fonde të tilla.¹³

¹³ Kompensimi për personat e trafikuar dhe shfrytëzuar në Rajonin e OSBE-së, OSBE/ODHIR, 2008, Fq. 10-11.

KREU II

NJË ANALIZË E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

2.1. Kushtetuta e RSH-së përbën ligjin më të lartë në hierarkinë e akteve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Ajo sanksionon disa të drejta, zbatimin dhe garantimin në praktikë i të cilave kontribuon në parandalimin dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore. Neni 3 i Kushtetutës sanksionon se “....., *dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij.....janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

Në pjesën e dytë të Kushtetutës disa dispozita sanksionojnë garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe mbrojtjen nga dhuna: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.*”¹⁴; “*Jeta e personit mbrohet me ligj*”¹⁵; “*Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar*”¹⁶.

Kushtetuta sanksionon se, *askujt nuk mund ti hiqet liria, përveç se në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj* (neni 27). Garantimi i të drejtës për të qenë i lirë, paraqet rëndësi në kushtet e përfshirjes së rrëmbimit si element i një vepre me rrezikshmëri shoqërore të përafërt me trafikimin. Gjithashtu, neni 26 i Kushtetutës sanksionon të drejtën e individit për të mos kryer punë të detyruar.¹⁷

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, nën moshën minimale për punën e fëmijëve, është një parashikim i qartë në Kushtetutë, i lidhur me dëmtimin e shëndetit, moralit dhe vënies në rrezik të jetës së fëmijës dhe zhvillimit normal të tij. Sanksionimi në mënyrë të shprehur i kësaj të drejte është me rëndësi, sa kohë që shfrytëzimi i punës ose shërbimeve të detyruara, përbën një element të trafikimit të personave, grave dhe të miturve. Një dispozitë kuptimplote e Kushtetutës është ajo që sanksionon se fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti¹⁸. Kjo, merr një rëndësi të veçantë, pasi

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 15, pika 1.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 21

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 25

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8417, datë 21.10.1998, Neni 26, “Askujt nuk mund t’i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.”

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 54, pika 1.

trafikimi i personave, grave dhe të miturve mund të shoqërohet me keqtrajtim, me dhunë fizike apo psikike.

2. 2. Ligjet

2.2.1 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Shteti Shqiptar ka bërë përmirësime legislative në legjislacionin material penal *duke përmirësuar strukturën e dispozitave ligjore, si dhe duke vendosur masa të rënda dënimi për autorët e veprës penale të trafikimit*. Me qëllim përmirësimit e dispozitave në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore janë bërë ndryshime në Kodin Penal të vitit 1995, me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001. Ndryshime mjaft të rëndësishme janë bërë në mënyrë të veçantë me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, në kuadrin e përfaqësjes së legjislacionit të brendshëm me Protokollin e Palermos.

Me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001 u shtua neni 110/a, “Trafikimi i njerëzve”. Nevoja që shtronte realiteti social dhe ratifikimi i Protokollit të Palermos “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve”, në plotësim të konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” bën të domosdoshme amendimin e Kodit Penal. Me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004 ligjvënësi përkufizoi më qartë veprat penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe parashikoi si figura të veçanta të veprës penale *trafikimin e personave¹⁹, trafikimin e femrave²⁰ dhe trafikimin e të miturve²¹*.

Me këto ndryshime legjislatori zhvilloi dhe zgjeroi më tej konceptin ligjor të trafikimit duke e lidhur atë me shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Gjithashtu u përcaktuan më qartë elementët dhe format e kryerjes së këtyre veprave penale.

Numri më i madh i grave, vajzave dhe fëmijëve të shfrytëzuar për trafikim ka rritur ndjeshmërinë e ligjvënësit ndaj mbrojtjes së veçantë të grave, vajzave dhe të miturve duke parashikuar me dispozita të veçanta trafikimin e tyre por edhe masa më të larta dënimi për autorët e tyre.²²

¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 110/a, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, neni 1.

²⁰ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 114/b, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, neni 2.

²¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Neni 128/b, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004, neni 3.

²² Kryerja e këtyre veprave dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milion deri në gjashtë milion lekë për trafikimin e femrave dhe me gjobë nga katër deri në gjashtë milion për trafikimin e të miturve. Për kryerjen e veprës së trafikimit të personave parashikohet si masë dënimi nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg dhe me gjobë nga dy milion deri në pesë milion lekë.

Me ndryshimet që pësoi Kodi Penal me ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004, u parashikua gjithashtu që vepra penale e trafikimit të personave, femrave dhe të miturve e kryer nga subjekte që shfrytëzojnë funksionin shtetëror ose shërbimin publik, të konsiderohet rrethanë cilësuese. Një ndryshim i tillë ka pasur efekte të rëndësishme parandaluese dhe ndëshkuese ndaj personave zyrtarë.

Legjislacioni i parashikon këto vepra të kryera në rrethana më të rënduara kur ato kryhen në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo shoqërohen me keqtrajtme dhe dhunë fizike, ose sjellin pasoja të rënda për shëndetin, sjellin vdekjen e të dëmtuarit apo kryhen nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik. Në këto raste konsiderohen vepra penale të cilësuar dhe parashikohen masa më të rënda dënimi.

Objekti i veprave penale të trafikimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë personale të sanksionuar në Kushtetutë, shëndetin dhe jetën e njeriut të cilat mbrohen në mënyrë të veçantë jo vetëm nëpërmjet dispozitave të Kodit Penal por edhe sistemit ligjor të brendshëm, i cili bazohet në rregullimet dhe parimet kushtetuese.

Nga ana objektive këto vepra penale kryhen me veprime aktive të kundraligjshme. Subjekt i këtyre veprave penale janë trafikantët. Nga ana subjektive këto vepra penale kryhen me dashje të drejtpërdrejtë me qëllimet e parashikuara nga dispozitat përkatëse.

Eshtë i rëndësishëm fakti që kuadri ligjor ka vazhduar të përmirësohet, sidomos në lidhje me mbrojtjen e veçantë të fëmijëve. Kështu, në vitin 2008, Kodi Penal ka pësuar ndryshime të rëndësishme me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar që konsistojnë në mbrojtjen e të miturve nga keqtrajtimi fizik ose psikologjik i kryer nga persona që janë të detyruar të kujdesen për ta (neni 124/b), mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i tyre për prodhimin e materialeve pornografike (neni 117) dhe në nenin 128/b të Kodit Penal "Trafikimi i të miturve", tek elementët e kësaj vepre shtohet edhe "shitja"

2.2.2 Kodi i Procedures Penale

(Kodi i Procedures Penale i RSH-së, Ligji nr.7905, datë 21.3.1995, ndryshuar me Ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002 dhe Ligjin nr.9276, datë 16.09.2004).

Kodi i Procedures Penale i RSH-së specifikon dy kategori të viktimave të veprave penale:

A. *Personi i dëmtuar nga vepra penale*

B. *Personi i dëmtuar nga vepra penale si i dëmtuar akuzues*

Viktimave, që kanë pësuar një dëm të shkaktuar nga një kategori e caktuar veprash penale mund ti drejtohen gjykatës drejtpërsëdrejti duke ngritur padi kundër dhunuesit.

Kodi i Procedurës Penale të RSH-së parashikon të drejtat e të dëmtuarit akuzues. Ai përcakton llojin e veprave penale²³ për të cilat i dëmtuari akuzues ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejtë në gjykatë.(Neni 58, Neni 59). Kodi i Procedurës Penale parashikon trembëdhjetë vepra të tilla penale. (Neni 59)

Të dëmtuarit akuzues i cënuar nga një vepër penale i është njohur një mbrojtje e posaçme ligjore me dispozitat shtesë të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2002 (Ligji nr. 8813, dt. 13.06.2002). Këto dispozita kanë përmirësuar mjaft të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale. P.sh., i dëmtuari ka një pozitë aktive që shprehet në të drejtën e tij për të parashtruar kërkesa në organin procedues dhe për të kërkuar marrjen e provave. Ai ka edhe të drejtën e ankimit në rastet kur kërkesa e tij nuk është pranuar nga prokurori.²⁴

I dëmtuari ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejtë në Gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. I dëmtuari nga vepra penale mund të paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor, vetë, ose nëpërmjet avokatit të tij, pasi është bërë më parë sigurimi i provave që ai disponon.

Viktima, e dëmtuar nga vepra penale e trafikimit të qënieve njerëzore, në procesin penal ka statusin e viktimës, por ajo nuk gëzon statusin e të qenit palë në procesin penal. Në procesin penal në lidhje me veprat e trafikimit të qënieve njerëzore, palët ndërgjyqëse janë prokurori dhe autori i këtyre veprave penale. (Trafikanti)

Nga lista e paraqitur në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale²⁵, konkludojmë se vepra penale e trafikimit të qënieve njerëzore, si dhe të gjitha veprat e tjera penale që lidhen me këtë fenomen, nuk mund të ndiqen me ankim në gjykatë, por ndiqen nga organi procedues. Për rrjedhojë, viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit vetëm përmes padisë civile në procesin penal, ose padisë në procesin civil. Në këtë rast, ato kanë statusin e palës në gjykim dhe mund të përfaqësohen me avokat, në lidhje me padinë e tyre në procesin penal. Por, nuk ka parashikime ligjore për mbrojtjen e tyre me avokat kryesisht.

Neni 361/pika 7 i Kodit të Procedurës Penale (i shtuar me ligjin nr.9276, datë 16.09.2004), parashikon pyetjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe të dëshmitarëve të mbrojtur nën masa të veçanta mbrojtjeje. Përveç mundësisë së marrjes në pyetje në distancë të tyre me anë të lidhjes audiovizive, gjykata, kur është vendosur ndryshimi i identitetit, urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri të mos jenë të dallueshëm. Kjo dispozitë përbën një arritje edhe në rastin kur në këtë pozitë mund të ndodhen viktimat e trafikimit, si të dëmtuara akuzuese.

²³ Veprat penale të parashikuara nga kjo dispozitë janë: rrahja, neni 90 i Kodit Penal, plagosja e rëndë nga pakujdesia, neni 91 i Kodit Penal, plagosja e lehtë nga pakujdesia, neni 92 i K. Penal, dhunimi i banesës, neni 112 i K. Penal, fyerja, neni 119 i K. Penal, shpifja, neni 120 i K. Penal, Ndërhyrje të pa drejta në jetën private, neni 121 i K. Penal, Përhapja e sekreteve vetjake, neni 122 i K. Penal, Mosdhënia e mjeteve për jetesë, neni 125 i K. Penal, Marrja e pa drejtë e fëmijës, neni 127 i K. Penal, Botimi i veprës së tjetrit në emër të vet, neni 148 i K. Penal, Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit, neni 149 i K. Penal, dhe Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera, neni 254 i K. Penal.

²⁴ Kodi i Procedurës Penale, Neni 58, pika 3, shtuar me ligjin nr.8813, datë 13.06.2002

²⁵ Për më gjerë shih: H. Islami, A. Hoxha, Ilir Panda, *Procedura Penale, Komentar*, Tiranë, 2003, fq. 141-143

Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar pyetjen e dëshmitarëve të mitur nga kryetari i trupit gjykues në lidhje me kërkesat dhe kundërshtimet e palëve, me qëllim mbrojtjen e të miturve nga riviktimizimi. Kjo është një masë e përshtatshme pasi përballja e të miturit me të akuzuarin për kryerjen e këtyre veprave penale, do të rrezikonte mirëqënien fizike dhe mendore të tij.

Sigurimi i provës gjatë hetimeve paraprake, në raste të caktuara (siç parashikohet në nenin 316 të Kodit të Procedurës Penale) rrit sigurinë e viktimës dhe shkurton kohën e procedurave gjyqësore. Përveç prokurorit, personi i dëmtuar, viktima e trafikimit mund të paraqesë kërkesë për ndjekjen e kësaj procedure.

2.2.3 Kodi Civil

Viktimat e trafikimit mund të përdorin mundësitë dhe mjetet ligjore që ofron Kodi Civil për të kërkuar dëmshpërblimin nga autorët e veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore. Ai parashikon rastet e përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit, në personin, në pasurinë e tij, si dhe përgjegjësinë për dëmin jo pasuror. Për të bërë të mundur kërkimin e dëmshpërblimit, bazuar në dispozitat e Kodit Civil duhet të ekzistojnë disa elemente ligjorë të domosdoshëm si sjellja e paligjshme, dëmtimi, marrëdhënia shkakësore dhe fajësia. (Për këtë çështje, më gjerë shih kreun III).

Në Kodin Civil nuk është parashikuar shprehimisht e drejta e të dëmtuarit për të kërkuar në rrugë civile dëmshpërblimin për rastet e shfrytëzimit në punë.

2.2.4 Kodi i Familjes

Rregullimi i marrëdhënieve familjare nëpërmjet Kodit të Familjes përbën një garanci për mbrojtjen e pjesëtarëve të familjes, në mënyrë të veçantë të fëmijëve, nga fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore. Gjithashtu, viktimat e trafikimit, ndeshen me një sërë problemesh ligjore në marrëdhëniet familjare.

Kodi i Familjes ndër **kushtet thelbësore për lidhjen e martesës** parashikon moshën 18 vjeç për bashkëshortët e ardhshëm, si dhe pëlqimin e tyre të lirë dhe të plotë për martesë. Martesa e lidhur pa pëlqimin e lirë, pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë dhe grua, e lidhur në ndikimin e një kanosjeje, dhe e lidhur nën moshën ligjore që parashikon ky Kod, është e pavlefshme.²⁶

Kodi i Familjes parashikon të njëjta të drejta dhe detyrime për bashkëshortët në martesë dhe në zgjidhjen e martesës, të cilat përbëjnë një garanci për një familje të shëndetshme dhe të mbrojtur nga fenomene të rrezikshme shoqërore. Midis të drejtave dhe detyrimeve që kodi i Familjes parashikon për bashkëshortët, mund të veçojmë të drejtën për “**kontribut kompensues**” (neni 147) dhe “**të drejtën e përdorimit të banesës**” (neni 153). Këto janë të drejta të rëndësishme për mbrojtjen e anëtarëve të familjes e në mënyrë të veçantë, për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve.

²⁶ Kodi i Familjes, nenet 33, 34, 36, 37, 39.

Neni 62 i Kodit të Familjes parashikon “**Masat kundër dhunës**”, për mbrojtjen e anëtarëve të familjes nga dhuna.

Kodi i Familjes përmban disa dispozita të rëndësishme në lidhje me kuptimin dhe ushtrimin e **përgjegjesisë prindërore**. Dënimi i prindit për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së fëmijës përbën një shkak për humbjen e përgjegjesisë prindërore.²⁷

Heqja e përgjegjesisë prindërore parashikohet në rastet e shpërdorimit të përgjegjesisë prindërore, pakujdesisë së rëndë në ushtrimin e saj, si dhe veprimeve që ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve. Në këto raste, gjykata vihet në lëvizje nga prindi tjetër, të afërmit e fëmijës ose prokurori²⁸.

2.2.5 Kodi i Punës

Kodi i Punës parashikon, mbrojtje të veçantë për të miturit dhe gratë (gratë shtatzëna dhe nënat e reja). Kjo mbrojtje konsiston në disa tregues si, caktimi i moshës minimale për punë, sanksionimi i punëve të lehta e të vështira, punëve të natës dhe kontrolli mjeksor, ndalimi i diskriminimit etj.

Kështu, në kreun X të Kodit të Punës përcaktohet specifikisht mbrojtja e veçantë për të miturit. Në bazë të nenit 98 të Kodit të Punës, ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14 deri me 16 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre.

Por, në Kodin e Punës nuk ka dispozita që të parashikojnë drejtpërsëdrejti mbrojtjen nga shfrytëzimi në punë. Me gjithatë, në një sërë dispozitash parashikohet mbrojtja e punësimit të gruas, ndalimi i punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, leja e lindjes, ndalimi i punës së natës për gratë shtatzëna dhe punëmarrësit nën moshën 18 vjeç. Kodi i Punës parashikon penalitete në rast të shkeljes së këtyre dispozitave duke kontribuar në parandalimin dhe mbrojtjen nga këto vepra.

Mbrojtja e të drejtave të grave dhe të miturve në punësim është rregulluar edhe me disa Vendime të Këshillit të Ministrave.²⁹ Garantimi i zbatimit të të drejtave të parashikuara nga Kodi i Punës dhe aktet e tjera në zbatim të tij, përbën një mjet të rëndësishëm për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore, element i të cilit mund të jetë edhe shfrytëzimi për punë i të gjitha subjekteve, në mënyrë të veçantë grave dhe fëmijëve.

²⁷ Kodi i Familjes, Neni 223:”Prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpunëtore për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtore në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj”

²⁸ Kodi i Familjes, neni 228.

²⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.207, datë 29.05.2002, “Për përcaktimin e punëve të vështira dhe të rrezikshme”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.205, datë 09.05.2002 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 384, datë 20.05.1996 “Për mbrojtjen e të miturve në punë”.

Kodi i Punës mund të parashikojë më mirë mjete ligjore për mbrojtjen e personave nga shfrytëzimi në punë.

2.2.6 Ligje të tjera,

- Ligji Nr.9110, datë 24.07.2003, “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda*”

Miratimi i Ligjit Nr.9110, datë 24.07.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, përbën një arritje të rëndësishme në përmirësimin e punës administrative e gjyqësore me qëllim gjykimin e shpejtë dhe të specializuar të veprave me rrezikshmeri të lartë shoqërore, ndër të tjera dhe veprave të trafikimit të personave, trafikimit të femrave dhe trafikimit të të miturve. Kompetencat e Gjykatës së krimeve të rënda janë parashikuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004.

- Ligji Nr.9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”

Ky ligj ka sanksionuar ngritjen e strukturave të posaçme administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, ndër të cilët, personave të dyshuar për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të Kodit Penal. Krijimi i Agjencisë për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara të krimit të organizuar, si një strukturë pranë Ministrisë së Financave, është një hap i rëndësishëm që shteti shqiptar ka ndërmarrë në zbatim të këtij ligji.

Ligji përbën një arritje në lidhje me asistencën dhe rehabilitimin e viktimave duke parashikuar krijimin e një Fondi të posaçëm për kompensimin e viktimave, në përjasje me aktet ndërkombëtare”.³⁰

Por, zbatimi në praktikë i këtij ligji, ka evidentuar paqartësi, sidomos në përcaktimin e qartë të kompetencave të strukturave përgjegjëse në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të sekuestrimit apo konfiskimit të pasurive të krimit të organizuar. Për pasurinë e administruar, ligji nuk përcakton raportin e pasurisë që do të shkojë në administrim të organeve të drejtësisë dhe pushtetit vendor, me pasurinë që do të shkojë për rehabilitimin dhe kompesimin e viktimave të trafikimit.

Vështirësitë e zbatimit në praktikë të ligjit Nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, tregojnë nevojën e hartimit të akteve nënligjore që

³⁰ Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, neni 15, pika 3,4

do të rregullonin më qartë skemën e kompensimit dhe do të garantonin të drejtën e viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore për kompensim.

- Ligji nr. 9205, datë 15.03.2004 “**Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë**”.

Përveç dispozitave të parashikuara nga kodi i procedurës penale, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, ligji në fjalë përfaqëson një akt të rëndësishëm. Ky ligj, përcakton në mënyrë të hollësishme masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Ligji ndihmon në plotësimin e kuadri ligjor për përmirësimin e punës në parandalimin dhe goditjen e veprave penale të trafikimit. Mbrojtja e dëshmitarëve, pra edhe mbrojtja e dëshmitarit të dëmtuar nga vepra penale e trafikimit të qënieve njerëzore (viktimës së trafikimit) përbën një garanci jo vetëm në ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave, por edhe në sigurinë e nevojshme ndaj viktimave, për ushtrimin e të drejtave ligjore, ndër të cilat, të drejtës për kompensim.

Konstatojmë se nuk tregohet vëmendja e duhur nga organet kompetente për të trajtuar viktimat e trafikimit si subjekt i këtij ligji. Numri i viktimave të trafikimit që kanë përfituar statusin e dëshmitarit të dëmtuar është ende i ulët.

Zbatimi në praktikë: Gjatë vitit 2006 janë marrë masa të posaçme mbrojtjeje në bazë të këtij ligji, vetëm për një dëshmitar të drejtësisë, në bazë të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Bashkëpunëtorja e drejtësisë ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë për veprën penale të trafikimit. Në këtë proces, personi që ka fituar statusin, ka qenë dëshmitar kryesor dhe viktimë e trafikimit. Mbi bazë të dëshmisë së saj janë akuzuar 4 shtetas, akuzat ndaj të cilëve janë vërtetuar në proces dhe janë dënuar nga gjykata me 9 vjet burg.³¹

- **Ligji nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”**

Neni 13³² i ligjit përcakton rrethin e personave që kanë të drejtë për të përfituar ndihmë juridike, si më poshtë:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë

³¹ *Njesia Antitrafik, Ministria e Brendshme*, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”, *Mars 2007*.

³² Ligji Nr. 10039 date 22.12.2008 “ Për ndihmën juridike”

ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj. Mjaft pozitiv është fakti që ky ligj siguron ndihmën juridike para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

Ky ligj duke garantuar shërbim ligjor *ex officio* për personat pa aftësi paguese, edhe për çështjet civile dhe administrative apo kur çështjet janë tepër komplekse, për herë të parë ofron mundësi që edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të jenë subjekt i mundshëm përfitues nga ky ligj.

Në përmbushje të detyrimeve që i burojnë shtetit shqiptar nga standardet ndërkombëtare në ligj parashikohet bashkëpunimi me Organizatat Jofitimprurëse. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike si institucion i parashikuar nga ky ligj ka autoritetin të lidhë kontrata bashkëpunimi me Organizatat Jofitimprurëse të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, për të mundësuar dhënien e kësaj ndihme.

- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, "***Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare***".

Duke konsideruar faktin se dhuna në marrëdhëniet familjare i bën më të dobët individët, në mënyrë të veçantë ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprave të përafërta me to, miratimi i këtij ligji përbën një kontribut në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë arsye, ky ligj përbën një hap të rëndësishëm në parandalimin e fenomenit të trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve. Ai ka disa karakteristika që e dallojnë nga ligjet e tjera në fushën penale e civile. .

Në radhë të parë, ligji parashikon mjete të posaçme administrativo-civile, pra ai nuk është një ligj penal. Midis tyre spikasin shërbimet, përfshirë edhe strehëzat, si dhe mbrojtja përjashtimore, përmes urdhrave mbrojtës që jep gjykata. Duke përkufizuar dhunën në familje dhe duke e konsideruar atë si një akt apo qëndrim të një personi ndaj një personi tjetër që cenon integritetin fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik të individit, ky ligj siguron mbrojtjen e anëtarëve nga dhuna në familje, në të gjitha format me të cilat ajo mund të shfaqet.

Së dyti, ligji synon të parandalojë dhe minimizojë dhunën në familje, si dhe të garantojë mbrojtje ligjore për të gjithë anëtarët e familjes që janë viktimat të dhunës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve. Gjithashtu, me përcaktimin e pjesëtarëve të familjes që mbrohen nga ky ligj, ai e shtrin mjaft efektin e tij, duke filluar nga subjektet e marrëdhënieve bashkëshortore, të gjinisë, birësimit, kujdestarisë, deri tek ato të bashkëjetesës, të ish-marrëdhënieve martesore apo të lidhjeve intime, përfshirë edhe lidhjet që nuk ekzistojnë më.

Së treti, në ligj vendosen qartazi detyrimet e autoriteteve përgjegjëse shtetërore që do të hartojnë politikat dhe strategjitë konkrete të parandalimit dhe të reduktimit të dhunës në

familje. Në këtë mënyrë krijohet një rrjet institucionesh bashkëvepruese, si në nivelin e pushtetit qendror, ashtu edhe në atë vendor.

Së katërti, në ligj parashikohen masa mbrojtëse, jo vetëm për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, por edhe për rehabilitimin e dhunuesit. Kjo, përbën një nga pikat më të forta që do të sjellë zbatimin e këtij ligji

Së pesti, ligji është një kontribut i rëndësishëm për forcimin e pushtetit gjyqësor. Ai bëhet një pikë e fortë e gjithë sistemit përmes sanksionimit të masave mbrojtëse kundër dhunës në familje. Parashikohen **urdhrat e menjëhershëm mbrojtës** dhe **urdhrat mbrojtës** si masa mbrojtëse që merren nga gjykata. Këto urdhra shërbejnë për të parandaluar një krim të mundshëm që mund të ndodhë në të ardhmen.

Së gjashti, ligji ka sanksionuar disa standarde të reja, si mjete garantuese për zbatimin me efikasitet të dispozitave të atij vetë, gjë që ndihmon për të mbështetur më mirë viktimën. E veçanta qëndron tek zgjerimi i rrethit të subjekteve që legjitimohen për të kërkuar marrjen e masave pranë organeve kompetente, tek afatet e posaçme procedurale, sidomos për gjykimin dhe dhënien e urdhrave mbrojtës të gjykatës, apo tek dhënia e menjëhershme e fuqisë ekzekutive ndaj vendimit gjyqësor për lëshimin e urdhrat mbrojtës, etj.

- Ligji nr. 9509, dt. 03.04.2006, për **“Moratoriumin për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë”**.

Një zhvillim pozitiv në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar në përgjithësi dhe trafikimit të qënieve njerëzore në veçanti, ka përbërë ligji për “Moratoriumin për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë”. Megjithëse ky ligj në vetvete, paraqet ndalime të forta për ushtrimin e veprimtarive të ligjshme e të dobishme përmes disponimit të mjeteve lundruese, u duk qartë, se në mungesë të kapaciteteve të Qeverisë për të kontrolluar lëvizjet, të cilat kishin si destinacion kalimin e paligjshëm të kufrit dhe trafikimin e qënieve njerëzore, u shndërrua në mjetin më të rëndësishëm qeveritar për parandalimin e fenomenit të trafikimit.

2.3 Akte nenligjore

- Në lidhje me disa të drejta ligjore të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendime me rëndësi të veçantë.

Me **vendimin nr.195, datë 11.04.2007**, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” Këshilli i Ministrave miratoi Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi. Ky Vendim parashikon që qendrat rezidenciale të ofrojnë ndër shërbimet e tjera, edhe asistencën ligjore për viktimat e trafikimit ose personat në rrezik për tu trafikuar. Vendimi ngarkon

Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për monitorimin e zbatimit të standardeve nga subjektet e licensuara.

- Me qëllim parandalimin e fenomeneve të trafikimit dhe integrimin e viktimave të trafikimit, Vendimi i Këshillit të Ministrave **Nr.632, dt.18.09.2003** “Për nxitjen e punësimit të punëkërkueseve të papuna femra” parashikon politika mbështetëse për punëdhënësit që punësojnë vajza dhe gra të trafikuar. Me **Urdhërin Nr.645, datë 20.03.2006**, të MPCSSH B “Për prioritetet e programit të nxitjes së punësimit për vitin 2006”, parashikohet që 50% e fondeve të këtyre programeve, janë planifikuar në zbatim të programit sipas VKM, Nr.632, dt.18.09.2003.
- **Urdhëri i Përbashkët** i Ministrave, miratuar nga Ministri i Brendshëm me nr.3394/4, datë 17.05.2006, nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.1192, datë 19.05.2006 dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme me nr.7590, datë 24.05.2006, ka parashikuar krijimin e **Autoritetit Përgjegjës**, për bashkërendimin dhe monitorimin e procesit të referimit me qëllim ndihmën, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave. Urdhri parashikon funksione të përbashkëta të këtij autoriteti si dhe përgjegjësi të veçanta për secilën Ministri.
- **Marrëveshje Bashkëpunimi** për krijimin e një **mekanizmi kombëtar** referues për identifikimin dhe asistencën e përmirësuar për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Qendrës Kombëtare pritëse për viktimat e trafikimit; Ministrisë së Rendit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtoria e Shërbimeve Konsullore; Organizatës Jofitimprurëse “Vatra”, “Tjetër Vizion” dhe IOM.
- **Strategjia Kombëtare** e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, plani i veprimit të kësaj strategjie miratuar me Urdhërin e kryeministrit Nr.25, datë 22.02.2005. Strategjia kombëtare dhe plani i punës për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimat të trafikimit 2004-2006

Strategjia u shoqërua edhe nga një **plan kombëtar veprimi**, i cili përfshin masa efektive për gjykimin e të dënuarëve trafikantë përmes amendimeve në legjislacion dhe zbatimit më të mirë të tij; programe riintegruese; shërbime; përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave; edukim dhe studime. Ky plan veprimi përcakton jo vetëm drejtimet kryesore të punës por edhe institucionet përgjegjëse dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e tyre.

Qeveria shqiptare ka përgatitur Strategjinë Kombëtare Shqiptare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore: **“Kuatri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit 2005-2007”**. Struktura e këtij dokumenti përshkohet nga parimet e standarteve ndërkombëtare. Disa nga fushat kryesore që gjejnë trajtim janë: hetimi dhe ndjekja penale e krimeve të

trafikimit, mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe e dëshmitarëve, parandalimi i trafikimit dhe ritrafikimit, kuadri bashkërendues dhe nevoja për studime.

KREU III

TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË PRAKTIKË

3.1 E drejta për informim.

Në legjislacionin shqiptar nuk është parashikuar ndonjë detyrim për policinë, prokurorët apo gjyqtarët, që të informojnë viktimat e krimeve të dhunshme, në mënyrë të vecantë trafikimit të qenieve njerëzore mbi të drejtat e tyre ligjore. Informimi i viktimave mbi të drejtat ligjore përbën një komponent shumë të rëndësishëm që i jep viktimës siguri dhe e bën të kuptojë se ka mjete ligjore dhe sociale që mund ti përdorë në favor të saj.

Nevojiten masa legjislative që ti garantojnë viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore informim ligjor që në momentin e kallzimit, hetimit dhe gjykimit të çështjes.

Profesionistët e sistemit të drejtësisë shpesh kanë informuar ose referuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit si edhe të gjitha qendrave të tjera të licensuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të cilat ofrojnë shërbime pritje, akomodimi ose reabilitimi.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare gjatë procesit të monitorimit (2004-2007) konstatoi se pavarësisht mungesës së një detyrimi formal në legjislacionin shqiptar për prokurorët dhe officerët e policisë gjyqësore për të informuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mbi të drejtat e tyre, në disa raste ata janë referuar në aktet ndërkombëtare. Megjithatë kjo nuk përbën një justifikim për mungesën e dispozitave në legjislacionin e brendshëm dhe udhëzues që do të parashikonin detyrimin për të informuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Nevojitet marrja e masave për të siguruar që viktimat e krimit, përfshirë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, informohen në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfitojnë asistencë që në kontaktin e tyre të parë policingë dhe prokurorinë dhe përgjatë procedurave gjyqësore. Kuadri ligjor dhe praktik i sistemit gjyqësor duhet të rishikohet me qëllim përcaktimin e detyrimeve të qarta për aktorët e tij dhe mundësimin e aksesit të viktimave të krimit në informacion dhe të drejtat e tyre (si psh përmes dispozitave në kodin e procedurës penale, udhëzimeve për officerët e policisë, prokurorët etj)

3.2 E drejta për ndihmë ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton mbrojtje ligjore falas për çdo shtetas, i cili gjykohet në një proces penal dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat. Neni 31/c i saj sanksionon se, “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe ti sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

Në të njëjtën frymë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në pikën 7 të nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale, është sanksionuar detyrimi i shtetit për të paguar shpenzimet e bëra për mbrojtjen vetëm ndaj të pandehurit, kur ky i fundit, nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat. Ndërsa, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në një proces gjyqësor penal ka vetëm pozitën e dëshmitares, e në këto kushte organi procedues dhe ai i gjyqimit nuk kanë detyrimin ligjor për t’i siguruar asaj avokat mbrojtës.

E drejta për tu mbrojtur me avokat i mundësohet viktimës së trafikimit vetëm në rastet kur merr pjesë në procesin penal me statusin e paditëses civile për të kërkuar dëmshpërblimin nga autori i veprës penale, në bazë të nenit 61 e 62 të K. Pr. Penale. Edhe në këtë rast shteti nuk garanton shërbim ligjor falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Edhe në këtë rast, shteti nuk garanton asistencë ligjore falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në këto kushte, Organizatat Jofitimprurëse të licensuara, në Tiranë dhe rrethe kanë ofruar shërbime ligjore dhe të tjera³³ falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në kuadrin e projekteve të ndryshme që mbështeten nga donatorë të huaj. Kontributi i tyre në ofrimin e shërbimeve ligjore falas në Shqipëri ka mundësuar trajtimin e shumë problemeve me natyrë ligjore duke përbërë mënyrën e vetme që mundëson mbrojtjen e të drejtave të personave me të ardhura të pamjaftueshme dhe të grupeve në nevojë.

Në kuadrin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare dhe detyrimeve që burojnë prej tyre për Shtetet Palë, Shteti shqiptar ka bërë përpjekje serioze për të garantuar të drejtën e shtetasve për shërbim ligjor falas.

Miratimi i Ligjit nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike” përbën një zhvillim të rëndësishëm në kuadrin ligjor në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtjen ligjore falas.

Është një sfidë për Organizatat Jofitimprurëse që adresojnë trafikimin e qenieve njerëzore që të krijohen organet përgjegjëse në zbatim të këtij ligji dhe të llobojnë në organet

³³ Ja si e vlerëson raporti i OSBE-ODHIR-it (Barcelonë 2007) për Shqipërinë këtë ndihmë të ofruar nga OJF-të: “Së paku një OJF, CLCI, ofron këshillime ligjore për viktimat e trafikimit, por kjo gjë nuk duket të jetë pjesë e mekanizmeve të referimit në shtet. IOM ofron asistencë ligjore falas për Qendrën shtetërore të pritjes dhe NGI menaxhon një strehëz, “Diferent and Equal”. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si CLCI dhe Klinikën ligjore për të miturit. Cilësia e shërbimeve të ofruara prej tyre ka një reputacion të mirë si eksperte në këshillimet ligjore...”

përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me synim që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të jenë subjekt që përfitojnë asistencë ligjore falas.

3.2.1 Zhvillime të nevojshme me qëllim rritjen e rolit të Organizatave Jofitimprurëse në lidhje me asistencën ligjore

Në procesin gjyqësor të zakonshëm është e vështirë që një organizatë të ndërhyjë pa prokurë. Kjo mund të ndodhë vetëm kur një subjekt palë në proces, i jep organizatës të drejtën që ta përfaqësojë atë. Në fakt, gjithmonë e më tepër po shtrohet nevoja e parashikimeve ligjore që do të legjitimonin një organizatë për ndërhyrje si palë e tretë në gjykim, ose për vënien në lëvizje të gjykimit. Parashikimi, së paku në raste të vecanta, i organizatave ose shoqatave që mund të ndërhyjnë si palë e tretë në gjykim do të ndihmonte në mbrojtjen efektive të drejtave dhe lirive të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Mjete dhe instrumente shumë të rëndësishme që mund të përdoren nga organizatat Jofitimprurëse në shërbim të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore janë edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut si edhe Komitetet e ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara nga konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është pjesë. Një sërë aktesh ndërkombëtare kanë krijuar komitete me kompetenca për të shqyrtuar ankesa të paraqitura nga qytetarë ose grupe të qytetarëve nga shtetet anëtare. Megjithëse mbetet disi e paqartë pozita procedurale e organizatave apo shoqatave për të ndërhyrë në këto procese, pasi nuk e gëzojnë statusin e palës së tretë, por ato mund të shfrytëzojnë vullnetin e palëve për ti lejuar ato që ti përfaqësojnë në këto instanca ndërkombëtare. Deri më sot nuk kemi ndërhyrje pranë mjeteve të tilla nga ndonjë organizatë jofitimprurëse shqiptare në mbrojtje të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Por, OJF-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në procesin e të provuarit të këtyre veprave.³⁴

Ndihma ligjore falas për personat e trafikuar është një element shumë i rëndësishëm jo vetëm si një e drejtë më vehte por edhe për të realizuar kuadrin e plotë të të drejtave ligjore për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në këtë kuadër garantimi i ndihmës ligjore falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore do të rriste mundësitë e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për kërkimin e të drejtave të tjera të qenësishme për rehabilitimin e tyre si e drejta për dëmshpërblim.

Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duke parashikuar asistencë ligjore falas për hartimin e kërkesë padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë për viktimat e dhunës në marrëdhëniet për arsye se dhuna në marrëdhëniet familjare i bën më të dobët individët, ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprave të përafërta me to.

³⁴ Kështu në vendimin nr.03, datë 16.01.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, regjistrat e organizatës jofitimprurëse “Terres Des Home”, e cila ofron mbështetje për fëmijët e trafikuar ose në trezik trafikimi janë shqyrtuar si prova.

3.3 E drejta për mbrojtje / siguria fizike

Një detyrim i qenësishëm, që buron nga aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga shteti shqiptar konsiston në përmirësimin e statusit të viktimës dhe ofrimin e asistencës për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, duke nënvizuar se, fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore mund të parandalohet dhe goditet me efektivitet, vetëm kur në qendër të masave që merren është viktima. Këto detyrime përfshijnë jo vetëm marrjen e masave legislative dhe/ose administrative që u sigurojnë viktimave informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative, por edhe asistencën, lehtësimin dhe pranimin, kthimin e personit të trafikuar pa vonesa të paarsyeshme, garantimin e sigurisë fizike të viktimave të trafikut, si dhe përfshirjen në sistemin ligjor të atyre masave që ju ofrojnë viktimave të trafikimit mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar.

Pra, një komponent shumë i rëndësishëm është siguria fizike e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore pa garantimin e të cilës ato nuk mund të gëzonin të drejta të tjera të rëndësishme si e drejta për kompensim, e drejta për tu informuar, e drejta për asistencë ligjore, etj.

Në këtë kuadër paraqet interes rrethi i masave mbrojtëse që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale për dëshmitarët, në pozitën e të cilëve ndodhen shpesh viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në Kodin e Procedurës Penale, (ndryshimet e parashikuara me ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004, në nenin 361/pika 7), parashikohet që dëshmitari të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive. Ky ndryshim lindi si nevojë e domosdoshme për sigurimin e efikasitetit në punën e organeve të procedimit penal dhe sistemit gjyqësor për goditjen e autorëve të krimit të organizuar; sigurimin dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë të lidhur me ta, të cilat pengojnë seriozisht dhe krijojnë vështirësi për vërtetimin e fajësisë dhe ndëshkimin e tyre.

Neni 316/a i Kodit të Procedurës Penale (i shtuar me ligjin nr.9276, datë 16.09.2004), parashikon pyetjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe të dëshmitarëve të mbrojtur nën masa të veçanta mbrojtjeje. Përveç mundësisë së marrjes në pyetje në distancë të tyre me anë të lidhjes audiovizive, gjykata, kur është vendosur ndryshimi i identitetit, urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri të mos jenë të dallueshëm. Kjo dispozitë përbën një arritje edhe në rastin kur në këtë pozitë mund të ndodhen viktimat e trafikimit.

Sigurimi i provës gjatë hetimeve paraprake, në raste të caktuara (siç parashikohet në nenin 316 të Kodit të Procedurës Penale) rrit sigurinë e viktimës dhe shkurton kohën e procedurave gjyqësore. Përveç prokurorit, personi i dëmtuar, viktima e trafikimit mund të paraqesë kërkesë për ndjekjen e kësaj procedure.

Ligjvënësi ka treguar një kujdes të vecantë për mbrojtjen e dëshmitarëve të mitur. Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar pyetjen e dëshmitarëve të mitur nga kryetari i trupit gjykues në lidhje me kërkesat dhe kundërshtimet e palëve, me qëllim mbrojtjen e të miturve nga riviktimizimi. Kjo është një masë e përshtatshme pasi përballja e të miturit me të akuzuarin për kryerjen e këtyre veprave penale, do të rrezikonte mirëqenien fizike dhe mendore të tij.

Ligji nr.9110, datë 24.07.2003”Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda”, në nenin 7 të tij parashikon rregulla të veçanta procedurale dhe parashikon *se gjykimi i çështjeve nga gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda bëhet me dyer të mbyllura edhe kur një gjë e tillë çmohet e domosdoshme për çështjen që gjykohet ose për procedime të tjera, në interes të sigurimit kombëtar, rendit publik, të drejtësisë dhe të mbrojtjes së pjesëmarrësve në proces. Në lidhje me pyetjen e dëshmitarëve ky ligj në nenin 8 të tij parashikon që gjykatat për krime të rënda të të lejojnë që pyetja e dëshmitarit, si dhe ballafaqimet dhe leximet e lejueshme të bëhen duke zbatuar, bashkërisht ose veçmas, rregullat vijuese:*

- a) në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual;
- b) pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit;
- c) në raste dhe mënyra të tjera të caktuara, sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Këto dispozita paraqesin një rëndësi të vecantë në rastet kur viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore merr pjesë në proces si në rastet kur ajo është me cilësinë e dëshmitares ashtu dhe në rastet kur paraqitet si paditëse civile në procesin penal për kërkimin e dëmshpërblimit nga autori i veprës penale.

Përveç dispozitave të parashikuara nga ligjet e mësipërme, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji nr.9205, datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” përfaqëson një akt tjetër të rëndësishëm. Ky ligj, përcakton në mënyrë të hollësishme masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Ligji ndihmon në plotësimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e punës në parandalimin dhe goditjen e veprave penale të trafikimit. Mbrojtja e dëshmitarëve, pra edhe mbrojtja e dëshmitarit të dëmtuar nga vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore (viktimës së trafikimit) përbën një garanci jo vetëm në ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave, por edhe në sigurinë e nevojshme ndaj viktimave, për ushtrimin e të drejtave ligjore.

Konstatohet se nuk tregohet vëmendja e duhur nga organet kompetente për të trajtuar viktimat e trafikimit si subjekt i këtij ligji. Numri i viktimave të trafikimit që kanë përfituar statusin e dëshmitarit të dëmtuar është ende i ulët.

Zbatimi në praktikë: Gjatë vitit 2006 janë marrë masa të posaçme mbrojtjeje në bazë të këtij ligji, vetëm për një dëshmitare të drejtësisë, në bazë të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm. Bashkëpunëtorja e drejtësisë ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë për veprën penale të trafikimit. Në këtë proces, personi që ka fituar statusin, ka qenë dëshmitar kryesor dhe viktimë e trafikimit. Mbi bazë të dëshmisë së saj janë akuzuar 4

shtetas, akuzat ndaj të cilëve janë vërtetuar në proces dhe janë dënuar nga gjykata me 9 vjet burg.³⁵

3.4 E drejta për rehabilitim e viktimave.

Qëndrimi profesional dhe i ndjeshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve të policisë ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore përbën një komponent të rëndësishëm, i cili jo vetëm lehtëson procesin hetimor dhe gjyqësor, por në të njëjtën kohë ndihmon në rehabilitimin e viktimave.

Gjyqtarët, prokurorët, punonjësit e policisë dhe avokatët reflektojnë në disa raste qëndrime jo të ndjeshme ndaj nevojave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Shpesh profesionistët e sistemit të drejtësisë i kushtojnë vëmendjen e duhur mbledhjes së provave me qëllim ndëshkimin e autorit të veprës penale por nuk njohin drejtësinë restauruese dhe rëndësinë e saj për viktimat.

Ka raste në të cilat gjuha e profesionistëve të sistemit të drejtësisë është diskriminuese ndaj viktimave. Kemi konstatuar nga monitorimi i vendimeve penale të formës së prerë, objekt studimi se në disa raste, terminologjia e përdorur në lidhje me viktimën e trafikuar, përdorimi i termave të tillë si “prostitutë”, “industri e qejfit”, nuk është në përputhje me standardet dhe e riviktimizon viktimën.³⁶

Në mbështetjen dhe restaurimin e viktimës një rol të rëndësishëm luan edhe mbështetja psikologjike e saj. Mendojmë se ky trajtim, si aspekt i rëndësishëm i praktikës gjyqësore është problematik dhe meriton vëmendje të veçantë.

Gjatë monitorimit, kemi evidentuar pak raste të trajtimit psikologjik për viktimat e trafikimit, nga punonjësit socialë, gjatë procesit hetimor e gjyqësor. Kështu, nga analiza e vendimeve të Gjykatës së Tiranës për periudhën 2004-2006, në një rast³⁷ rezultoi se gjykata ka kërkuar pjesëmarrjen e një eksperti psikolog për të asistuar viktimën e trafikimit. Ndërsa, në një rast tjetër³⁸ (nga pjesa arsyetuese e vendimit), rezultoi se viktimat është pyetur nga një psikologe, për shkak të moshës së saj të mitur.

Në qendrat ku mbahen ish-viktimat e trafikimit ofrohet një asistencë e tillë, por kjo asistencë duhet të jetë e vazhdueshme, si gjatë zhvillimit të procesit penal, ashtu edhe në mbarim të tij, me qëllim që viktimat të rehabilitohet nga këndvështrimi psikologjik dhe moral.

³⁵ *Njesia Antitrafik, Ministria e Brendshme*, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”, *Mars 2007*.

³⁶ Shih vendimin nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

³⁷ Vendim i datës 12.11.2004 (Gjykim lidhur me nenin 101 të Kodit Penal)

³⁸ Vendim i datës 09.05.2006 (Gjykim lidhur me nenin 101 të Kodit Penal)

Siguria e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, mbështetja psiko-sociale në çdo hap, rritja e nivelit të tyre të ndërgjegjësimit mbi të drejtat ligjore dhe sociale, këshillimi ligjor, përfaqësimi i çështjeve në gjykatat e shkallëve të ndryshme, asistenca ligjore për kërkimin e dëmshpërblimit nga shteti ose autori i këtyre veprave penale, ofrimi i shërbimeve ligjore për çështje familjare dhe të tjera për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të lidhura ngushtë me njëra tjetrën konsiderohen komponentë të rëndësishëm që mund të bëjnë realitet rehabilitimin dhe integrimin e këtij taget grupi në shoqëri

3.5 Informacion në lidhje me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore bazuar në monitorimin e çështjeve penale gjyqësore (mbi trafikimin e qenieve njerëzore) në Shqipëri për periudhën 2004 -2007.

Tabela nr.1: Deklarimi i viktimës.

Viti	Në sallë	Me letër porosi	Sigurim prove	Pa të dhëna
2004	3	-	5	3
2005	2	-	4	-
2006	1	1	5	3
2007	8		2	
Totali	14	1	16	6

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare nëpërmjet monitorimit të kryer të vendimeve gjyqësore penale për periudhën 2004-2007 dhe monitorimit të seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda gjatë vitit 2007, ka konstatuar se, pothuajse në çdo rast të gjykimit të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore, dëshmia e viktimës së trafikimit është realizuar në bazë të nenit 316 e vijues të Kodit të Pr.Penale me sigurim prove, si dhe bazuar në nenin 361/7, me pyetje në distancë.

Gjatë vitit 2007 vihet re një tendencë në rritje e dëshmive në sallë të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Nga tabela rezulton se kemi një numër të ulët të viktimave të trafikimit që deklarojnë dëshminë e tyre edhe në proceset gjyqësore. Parë në këtë këndvështrim, si dhe në kuadër të detyrimeve për unifikimin e legjislacionit dhe praktikave me standardet ndërkombëtare, organet e drejtësisë e kane konsideruar si një prioritet sigurinë dhe mirëqenien e viktimës.

Bashkëpunimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me organet e drejtësisë vlerësohet si mjaft i rëndësishëm për ndjekjen penale të autorëve, për shkak të elementëve të këtyre veprave dhe mënyrave se si kryhet trafikimi i qenieve njerëzore.

Me qëllim zbehjen e bashkëpunimit të viktimave me organet e drejtësisë, trafikantët ushtrojnë presione në formën e kërcënimeve për jetën e viktimave dhe të familjarëve të

tyre. Në këto kushte ato hezitojnë të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, edhe gjatë proceseve gjyqësore. Mbrojtja e viktimave, ruajtja e anonimatit, dhe garantimi i sigurisë së viktimave përbën një domosdoshmëri, për ndjekjen penale të autorëve të këtyre veprave.³⁹ Në ndonjë rast, nga organet e drejtësisë nuk është ofruar siguria dhe mjedisi i përshtatshëm me qëllim që viktima të bashkëpunojë me këto organe. Ky qëndrim ka sjellë dhe raste të gjykimit dhe dënimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me akuzën e “dëshmisë së rreme”, neni 306/1 i Kodit Penal.⁴⁰

Qëndrime të pakujdesshme, madje në ndonjë rast të veçantë edhe veprime në kundërshtim me ligjin të organit të akuzës, kanë krijuar mundësi për ritrafikimin e viktimës. Kështu, në vendimin nr.3, datë 17.01.2006 të Gjykatës së Krimeve të rënda, arsyetohet se: **“E dëmtuara, e mashtruar si dhe nën presionin edhe të prindërve të saj, ka tërhequr kallëzimin dhe prokuroria e rrethit Bulqizë, ndonëse vepra penale që rezulton nga materiali kallëzues nuk përfshihet në ato të parashikuara nga neni 284 të K.Pr.Penale, ka vendosur mosfillimin e çështjes penale ndaj të pandehurit A!!!”** Në vijim të këtij qëndrimi, e dëmtuara A, u ritrafikua.

Format e ndjekura nga trafikantët për tërheqjen e viktimës në trafik.

Tabela nr.2: Format e përdorura nga trafikantët .

Viti	Mashtrim për punë	Mashtrim për martesë
2004	4	5
2005	0	6
2006	2	5
2007	1	5
Totali	7	21

-Gjatë vitit 2004, në 5 raste, të akuzuarit kanë përdorur formën e mashtrimit për martesë dhe në 4 raste mashtrimin për punë.

-Gjatë vitit 2005, në 6 raste është përdorur forma e mashtrimit për martesë.

-Gjatë vitit 2006, në 5 raste është përdorur mashtrimi për martesë dhe në dy raste mashtrimi për punë.

-Gjatë vitit 2007, në 5 raste trafikantët kanë përdorur mashtrimin për martesë dhe në një rast mashtrimin për punë.

Problemet social ekonomike me të cilat është përballur viktima.

³⁹ Përmushja e kësaj domosdoshmërie përbën një detyrim që buron nga neni 25/1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, i cili kërkon që shteti shqiptar të marrë masat e duhura për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, veçanërisht në rastet e kërcënimit për hakmarrje ose terrorizimin e tyre. Ky detyrim përforcohet edhe nga Rekomandimet e Komitetit CEDAE, në janar të vitit 2003, i cili i kërkon Palës Shtetërore të sigurojë që gratë dhe vajzat e trafikuara kanë mbrojtjen dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë që t'i mundësojë të dëshmojnë kundër trafikantëve.

⁴⁰ Vendimi nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.


-Në 15.3% të çështjeve të gjykuara në vitin 2004, kanë rezultuar probleme të mprehta ekonomike, në 30.7% të tyre kanë rezultuar probleme familjare, në 46.1 % të tyre është ushtruar dhunë e formave të ndryshme dhe në 7.6% të tyre është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

-Gjatë vitit 2005, në 66.6% të rasteve ka rezultuar dhunë e të gjitha formave, në 22.2% të rasteve kanë rezultuar probleme ekonomike dhe familjare dhe në 11.1% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

-Gjatë vitit 2006, në 25% të rasteve, problemet ekonomike dhe familjare janë prezentë, në 62.5% të tyre dhuna e formave të ndryshme është prezentë dhe në 12.5% të rasteve është ushtruar torturë mbi viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë vitit 2007, në pesë raste viktimat janë përballur me probleme ekonomike familjare dhe në pesë raste ato janë përballur me dhunë të formave të ndryshme.

Grafiku : Problemet me të cilat janë përballur viktimat e trafikimit.



Disa forma të ashpra dhune me të cilat janë përballur viktimat e trafikimit janë detyrimi për ndërprerjen e shtatzënisë, tentativa për mbyetje të viktimës, goditje me shkelma dhe grusht⁴¹, kërcënimi për prerje damarësh, rrahje egërsisht me mjete të forta, kërcënim për vrasje, kërcënim me vdekje nëse nuk tërheq kallëzimin, kërcënim për të mos parë më anëtarët e familjes, rrahje sa për dy ditë viktimat nuk është ngritur nga shtrati,⁴² kërcënim se do i presin kokën e forma të tjera çnjerëzore. Në disa raste viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është kërcënuar me vdekje në rast të mos tërheqjes së kallëzimit ose i janë premtuar para për tërheqjen e denoncimit. Në rastin e gjyqimit të veprës penale të trafikimit të fëmijëve kemi konstatuar detyrimin e fëmijëve të lypin në semaforët e Athinës, të shesin lule e kartopiceta në llogari të trafikantëve, të kërcënohen etj.⁴³

⁴¹ Referuar vendimit nr.68, datë 15.12.2005, Vendimi nr.3, datë 28.04.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴² Vendimi nr.29, datë 11.06.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴³ Vendimi nr.03, datë 16.01.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Në një përqindje shumë të lartë të rasteve viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore përballen me braktisjen e familjarëve të tyre⁴⁴.

Në disa raste viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk gëzojnë të drejtat e tyre ligjore edhe për shkak të mos gjykimit të çështjes penale me ndjeshmëri sociale nga pikëpamja gjinore. Kështu në vendimin nr.14, datë 19.03.2007, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në arsyetimin e saj në lidhje me akuzën e kryerjes nga i pandehuri K.M të veprës penale të kryerjes së “marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç” argumenton se nuk provohet që mbi të miturën është ushtruar dhunë fizike ose psikike dhe nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet e të dëmtuarës për mbylljen e gojës dhe përdhunimin. Ky arsyetim nuk është në logjikën e një fryme të re që është përcjellë në vendimet e Gjykatës Evropiane të Strasburgut e cila ka konsideruar veçoritë specifike dhe psikologjike të reagimit të një të miture gjatë kryerjes së marrëdhënies seksuale me dhunë (*M.C kundër Bullgarisë*).⁴⁵

⁴⁴ Vendimi 09, datë 12.02.2007 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁴⁵ Shih rastin M.C kundër Bullgarisë.

KREU IV

ÇËSHTJE TË KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

4.1. Zhvillimet e legjislacionit Shqiptar për kompensimin e viktimave të trafikimit.

1. **Kushtetuta** e Republikës së Shqipërisë

Kohët e fundit, ka një evolucion të dukshëm të standardeve ndërkombëtare në lidhje me aksesin në drejtësi të viktimave të krimeve të dhunshme, për të drejtën e tyre për kompensim. Ky fakt, po ndikon edhe në legjislacionin shqiptar për të krijuar mundësi të reja, si në kuadrin e procesit gjyqësor, ashtu edhe në sajë të skemës së kompensimit të vendosur nga Shteti.(shih 4.4)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e parashikon si një nga të drejtat themelore, të drejtën e shtetasit për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore (neni 44). Kjo e drejtë i rezervohet ligjit për të përcaktuar modalitetet e zbatimit të saj.

Ligji Nr.9381, dt.28.04.2005 “*Për kompensimin e burgimit të padrejtë*”, është një nga ligjet kryesore i miratuar në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës. Që nga viti i miratimit të tij, praktika gjyqësore ka dëshmuar rritjen e rasteve të zhdëmtimit që i kërkojnë gjykatës për sjellje të paligjshme të organeve të policisë, ose për burgim të padrejtë.

Mekanizmi i parashikuar nga Kushtetuta për pranimin e akteve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm juridik, e lejon plotësisht gjyqtarin që të vendosë në lidhje me kërkesat për kompensim/zhdëmtim, duke iu referuar drejtpërdrejt konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

4.2 Mekanizmat e parashikuara nga ligji shqiptar për kompensimin e viktimave të trafikimit.

Legjislacioni procedural shqiptar parashikon mundësinë për kompensimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, përmes mjeteve procedurale në dy procese: *padisë civile në procesin penal* dhe *padisë për kërkimin e dëmit në procesin civil*. Dallimi kryesor midis këtyre proceseve është fakti se, padia civile në procesin penal lidhet vetëm me kërkimin e dëmit material. Kodi i procedurës penale nuk e parashikon mundësinë për të kërkuar edhe “dëmin moral” për veprat e trafikimit të qenieve njerëzore. Ai ka parashikuar mundësinë për të kërkuar shpërblimin e dëmit (pa e kushtëzuar medoemos me dëmin material), vetëm në rastin e kërkimit nga ana e të dëmtuarit akuzues, përpara gjykatës⁴⁶. Sidoqoftë, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë mundësi ligjore të kërkojnë edhe dëmin moral, përmes procesit civil. Në përgjithësi, mjetet ligjore për kërkimin e dëmit mund të kërkohen në KODin e Procedurës Penale, KODin Civil, si dhe në ligjin Nr.9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”. Nga pikëpamja e praktikës gjyqësor vlen të përmendet Vendimi Unifikues, nr. 12, dt. 14.09.2007, i kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili unifikon praktikën gjyqësore në kuptimin e dëmit material e moral.

Statusi i viktimës në lidhje me padinë civile në procesin Penal. Kodi i Procedurës Penale (nenet 58-68)

Përmes këndvështrimit të standardeve ndërkombëtare, në mekanizmat shqiptarë të së drejtës për dëmshpërblim mund të dallojmë qartë:

- të drejtën për të kërkuar dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi, përmes procesit penal dhe atij civil;
- të drejtën për dëmshpërblim nga fondet shtetërore të krijuara nga konfiskimi i pasurive të paligjshme të personave pjesëmarrës në krimin e organizuar, përmes administrimit të pasurive të konfiskuara nga institucioni përgjegjës.

Në përgjithësi, mjetet ligjore për kërkimin e dëmit mund të kërkohen në Kodin e Procedurës Penale, Kodin Civil, si dhe në ligjin Nr. 9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”. Vlen të përmendet gjithashtu, Vendimi Unifikues, nr. 12, dt. 14.09.2007, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me kuptimin e dëmit material e moral.

Legjislacioni procedural shqiptar parashikon mundësinë për kompensimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore përmes *padisë civile në procesin penal* dhe *padisë për kërkimin e dëmit, në procesin civil*.

Sidoqoftë, kodi i procedurës penale, në rastin e kërkesës së të dëmtuarit akuzues përpara gjykatës, ka parashikuar kërkimin e shpërblimit të dëmit, pa e kushtëzuar medoemos me dëmin material⁴⁷.

Ky qëndrim i Kodit të procedurës penale, është interpretuar edhe nga doktrina juridiko-penale shqiptare. “Vëllimi i të drejtave që ka paditësi civil në procesin penal përcaktohen nga qëllimi që ka ky institut për të siguruar zëvendësimin e dëmit material të shkaktuar nga kryerja e veprës penale”⁴⁸.

⁴⁶ Shih neni 59 i Kodit të Procedurës penale

⁴⁷ Shih neni 59 i Kodit të Procedurës penale

⁴⁸ Fehmi Abdiu, “*Padia civile në procesin penal shqiptar*”, Botim Pex, Tiranë, 2003, Fq.82

Dallimi kryesor midis këtyre proceseve është fakti se, padia civile në procesin penal lidhet vetëm me kërkimin e dëmit material, kurse dëmi moral mund të kërkohet vetëm përmes procesit civil.

Statusin e paditësit civil në procesin penal e fiton viktimi e veprës penale, që paraqet një padi civile për kërkimin e dëmit në procesin penal që zhvillohet kundër të pandehurit, ose të paditurit civil. Kurse, statusin i të dëmtuarit akuzues e kanë viktimat që kanë pësuar dëm nga një veprë penale të një rëndësie të vogël, dhe ngrnë akuzën drejtpërdrejt në Gjykatë. Përfshihen në këtë kategori vetëm 13 figura të veprave penale, sipas kategorizimit të përcaktuar në listë të mbyllur që ka bërë vetë Kodi i Procedurës Penale (neni 59)⁴⁹.

Në krahasim të pozitës juridike midis dy kategorive, do të evidentonim:

1. I/E dëmtuari/a akuzues/e, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë si palë në gjykim, ndërkohë që viktimi që nuk është palë e dëmtuar, në përputhje me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale të sipërpërmendur, mund të denoncojë veprën pranë organeve të procedimit (Prokurorisë) dhe ruan statusin e dëshmitares në procesin penal të iniciuar nga Prokurori.
2. E dëmtuara akuzuese merr pjesë si palë në gjykim dhe ka të drejtë të mbrohet me avokat, ndërkohë që viktimi e veprës penale ka vetëm statusin e dëshmitares dhe mbështetjen e organit procedues shtetëror.
3. Në lidhje me të drejtën për kompensim, e dëmtuara akuzuese, e cila paraqet kërkesë në gjykatë dhe është palë në gjykim, ka të drejtë që të kërkojë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit (material e moral). Në rastin tjetër, viktimi e veprës penale mund të kërkojë shpërblimin e dëmit vetëm përmes padisë civile në procesin penal, e cila lidhet vetëm me kërkimin e dëmit material.

4.3 Kërkimi i dëmit material në procesin penal

Neni 61 i K.Pr.P i njuh personit ose trashëgimtarëve të tij, të drejtën për të kërkuar vetëm dëmin material, përmes padisë civile në procesin penal, kundër të pandehurit (të paditurit civil). E drejta për të kërkuar dëmin material është e lidhur me kuptimin që Kodi Civil i ka dhënë dëmit material.⁵⁰ Për të kuptuar më mirë këtë, një ndihmë të veçantë na jep vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 12, dt. 14.09.2007). Në bazë të këtij vendimi, “Dëmtimi i shëndetit (demi biologjik) përbën, ne thelb, cenimin e se mirës se shëndetit, te integritetit fizik dhe/ose psikik te njeriut”. Pavarësisht se Kodi ynë civil e rreshton dëmin ndaj shëndetit si dëm jopasuror, duhet theksuar se mund të veçohet dëmi biologjik si dëm pasuror.

⁴⁹ Kanë statusin e të dëmtuarit akuzues viktimat nga veprat penale që vijojnë:

1. Dëmtime të tjera me dashje (rrahja)
2. Plagosja e rëndë nga pakujdesia
3. Plagosja e lehtë nga pakujdesia
4. Dhunimi i banesës (hyrja dhe qëndrimi pa pëlqim në banesë)
5. Fyerja;
6. Shpifja;
7. Ndërhyrje të padrejta në jetën private;
8. Përhapja e sekretet vetjak;
9. Mosdhënia e mjeteve për jetesë;
10. Marrja e padrejtë e fëmijës;
11. Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet;
12. Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit;
13. Shkelja e paprekshmërisë së banesës;

⁵⁰Neni 640-644

Kolegjet e bashkuara, pavarësisht nga lloji, theksojnë se ky dëm, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari. Pra, dëmshpërblimi për dëmtimin e shëndetit sipas nenit 625/a të K.Civil kërkohet në mënyrë të pavarur nga kërkimi për dëmin pasuror të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, i parashikuar në nenin 641 të K.Civil. Njëkohësisht, përbën interes të ligjshëm të cenuar edhe pakësimi i pasurisë së të dëmtuarit në formën e shpenzimeve që ai përballon për përkujdesje dhe, në veçanti, për mjekimin e shëndetit të cenuar si rrjedhojë e pandërprere e të njëjtit fakt të paligjshëm (*shih: vendimi unifikues nr. 12, dt. 14.09.2007*)⁵¹.

Në këtë kuadër një problem që shtrohet për shqyrtim është se si duhet ta kuptojmë “dëmin material” që kërkohet përmes padisë civile në procesin penal? Neni 61 i Kodit të Procedurës penale vendos: “Ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe kërkimin e dëmit”. Në praktikën gjyqësore dhe doktrinën juridike shqiptare, janë shprehur mendime të ndryshme mbi kuptimin e dëmit në përgjithësi, dhe atij material në veçanti. Për këtë ka ndikuar edhe kuptimi i mëparshëm në legjislacionin shqiptar, i përgjegjësishë materiale dhe asaj civile. Kështu, p.sh., ka autorë që mendojnë se përmes padisë civile në procesin penal mund të kërkohet vetëm dëmi efektiv dhe asnjë dëm tjetër që vjen medoemos në të ardhmen, si rezultat i krimit të kryer nga i padituri civil, ose fitimi i munguar. Kështu, psh., sipas kësaj logjike në rastin e grabitjes me dhunë, *paditësi civil mund të kërkojë vetëm të hollat e vjedhura, jo ato që ka harxhuar në institucionin shëndetësor për shërim*⁵². Mendoj se një kuptim i tillë, e ngushton mjaft qëllimin nën 61 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do ta bënte shumë të vështirë efektivitetin e padisë civile në procesin penal, sidomos në rastet kur dëmi ka ardhur nga vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore.

Neni 61 i K.Pr.P e trajton dëmin material në dy aspekte: në kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit. Këto terma nuk janë të njëjtë. P.sh., termi në ShBA kthimi i pasurisë mund të kuptohet si “restitution” (kthim), si pagesë që i bëhet viktimës nga i pandehuri në zbatim të vendimit të gjykatës, kurse në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë “restitution” do të thotë kthim i mallrave dhe pasurisë tek pronari i ligjshëm. Në legjislacionin tonë, kthimi i pasurisë përputhet me këto të fundit. Në shembullin që zgjodhëm për ilustrim, kthimi i pasurisë është kthimi i parave të grabitura tek paditësi civil që është pronari i tyre dhe viktimë e grabitjes. Por, ky term nuk mund të barazohet me kuptimin e dëmit material. Prandaj, është e nevojshme të theksojmë se, kthimi i sendit është kategori më e ngushtë nga termi “shpërblimi i dëmit”, në rastin tonë shpërblimi i dëmit material. Do të ishte mirë, që përkufizimi dhe qëllimi i dëmit material në kontekstin kombëtar, të jepej nga ligji. Vetëm në vendet e traditës së precedentit gjyqësor jepet nëpërmjet precedentëve. Sidoqoftë, kjo zbrazëti e ligjit nuk mund të bëhet pengesë për kërkimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, pasi mund t’i referohemi standardeve ndërkombëtare ose praktikës gjyqësore.

Në bazë të standardeve ndërkombëtare, “Dëmi material” i referohet humbjes financiare ose pasurore, p.sh., shpenzimet mjekësore, të funeralit dhe shtrimit në spital, humbja e fitimeve të ardhshme dhe përfitimeve që rrjedhin nga punësimi, pagat e papaguara,⁵³ dhe kostot e dëmeve ndaj pronës⁵⁴. Dëmi

⁵¹ Për më gjerë, shih: Shih: Marjana Tutulani, “Dëmi jopasuror (moral), nën rregullimin juridik të Kodit Civil”, botuar në Jeta Juridike, Nr. 1, Gusht 2003

⁵² Shih Fehmi Abdiu, vepër e cit. fq. 50-51

⁵³ Duhet theksuar se pagat e papaguara janë një nënkategori e dëmit material. Ka mundësi që në disa padi sipas të drejtës së punës që pretendojnë vetëm pagën, shpërblimi mund të quhet “pagë e papaguar”.

material përfshin gjithçka që ka të bëjë me humbjet financiare ose pasurore. Këtu përfshihet edhe dëmi pasuror ndaj shëndetit, ose ai që sot është mbiquajtur si dëm biologjik. Ky qëndrim përputhet edhe me trajtimet që kanë bërë disa autorë shqiptarë⁵⁵, si dhe me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë.

Për sa më sipër mund të konkludojmë që qëllimi i padisë civile në procesin penal nuk mund të reduktohet vetëm në kthimin e pasurisë tek pronari i ligjshëm, por edhe tek shpërblimi i dëmit material, i cili mund të kuptohet si dëm pasuror i ardhur nga vepra penale, që përfshin të gjitha llojet e humbjeve financiare ose pasurore. Këto humbje nuk mund të mbulohen krejtësisht as nga skema e sigurimeve shoqërore. Natyrisht, këto humbje janë plotësisht të kërkueshme edhe në procesin civil, proces i cili është ekskluziv për të kërkuar dëmin moral, jopasuror.

Legjitimimi i paditësit civil në procesin penal. Kodi i Procedurës Penale (neni 62) përcakton fazën dhe afatet e legjitimitit të paditësit civil në procesin penal. Legjitimimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi procedues derisa të mos ketë filluar procedimi gjyqësor. Ky afat nuk mund të zgjatet në asnjë rast. Është e qartë se legjitimimi i kërkesës do të bëhet nga gjykata përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor. Por, mendoj se këtu duhet të dallojmë si dy momente të shkëputura, legjitimimin e kërkesës dhe paraqitjen e kërkesës.

Formulimi i nenit 62 të K.Pr.P., lë hapësira të dëshirueshme në lidhje me momentin e paraqitjes së padisë civile në procesin penal. Ai nuk e përjashton mundësinë që kërkesa të paraqitet përpara Prokurorit si organ procedues, i cili mund të kryejë edhe veprime në lidhje me të, pavarësisht se legjitimimin do ta bëjë më tej Gjykata, përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor. Kjo praktikë është e domosdoshme të ndiqet, pasi ndihmon mbarëvajtjen e shqyrtimit të padisë civile në procesin penal. Në radhë të parë, që në fazën e hetimit të çështjes, viktimi duhet të ndihmohet me informacion në lidhje me të drejtën e saj për të kërkuar shpërblimin e dëmit, si dhe të pranohet në fashikullin e çështjes, padia civile e paraqitur prej saj. Në ligjin shqiptar nuk ka parashikime të detajuara ligjore që të parashikojnë detyrimin e ndonjë prej organeve shtetërore për të informuar viktimën, apo për të kërkuar provat në lidhje me padinë civile në procesin penal. Por, mendojmë se marrja e provave për procedimin e fajtorit, lidhet edhe me procesin e të provuarit të padisë civile në procesin penal, prandaj është më se e nevojshme që padia të paraqitet që në fillimet e procedimit. Kjo do të ndihmonte edhe gjykatën penale në shqyrtimin e padisë civile, përndryshe veçimi i saj do të ishte i paralajmëruar, gjë që do ta shndërronte padinë civile në procesin penal në një institut të panevojshëm.

Gjykata penale është e lejuar plotësisht që të veçojë padinë civile nga procesi penal dhe ta dërgojë atë për gjykim në procesin civil. Kjo mund të ndodhë jo vetëm me kërkesë të palëve, por edhe kryesisht, nëse gjykimi i padisë civile vështirëson ose zvarrit procesin penal⁵⁶. Në përgjithësi, veçimi i padisë civile në procesin penal, bëhet shkas për zgjatjen e procedurave të gjykimit. Praktika shqiptare në këto raste, ka vërtetuar se ka qenë gati e pamundur të bëhet gjykim i saj në procesin civil, pa përfunduar më parë procesi penal.

Në rastin D.S. kundër A.A., edhe pse gjykata ka marrë në shqyrtim një padi civile në procesin penal të paraqitur nga viktimi dhe ka vendosur veçimin e saj, nuk ka pasqyruar asgjë nga kjo, në vendimin e saj përfundimtar.

⁵⁴ *Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region*, OSCE/ODHIR, 2008, fq.16

⁵⁵ Shih: Marjana Tutulani, “Dëmi jopasuror (moral), nën rregullimin juridik të Kodit Civil”, botuar në *Jeta Juridike*, Nr. 1, Gusht 2003

⁵⁶ Sa më sipër, është vendosur me një shtojcë, që kodit të Procedurës Penale i është bërë në vitin 2002 (Ligj nr. 8813, dt. 13.6.2002).

Veçimi i Padisë civile në Procesin Penal disponohet me vendim të ndërmjetëm. Gjykata ka detyrimin të paraqesë këtë vendim të ndërmjetëm në vendimin e saj përfundimtar, ndoshta në pjesën e tij arsyetuese. Kjo buron nga detyrimi i Gjykatës për të dhënë përgjigje në lidhje me të gjitha kërkesat procedurale të palëve, por njëkohësisht, buron edhe nga e drejta e palës për të ankimuar vendimin. Në këtë rast, paditësi civil në procesin penal ka të drejtë të ankimojë vendimin e ndërmjetëm të gjykatës në lidhje me padinë e tij, së bashku me vendimin përfundimtar. Kjo e drejtë lind në bazë të K.Pr.P, i cili parashikon se, “*ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankim kundër vendimit*”.

E drejta për t’u përfaqësuar me avokat.

Shërbimet e këshillimit për personat e trafikuar janë një element thelbësor i së drejtës për dëmshpërblim. Për të kërkuar kthimin e dëmit, personat e trafikuar duhet të kenë dijeni për të drejtat e tyre dhe si të përfitojnë prej tyre. Madje, standardet ndërkombëtare diktojnë edhe ekzistencën e masave që garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e personit gjatë kohëzgjatjes së procedurës së padisë. Kjo do të thotë që strehimi i përshtatshëm, ndihma sociale, këshillimi ligjor, ndihma mjekësore dhe leja e qëndrimit janë të drejta ndihmëse thelbësore, pa të cilat mundësia e përfitimit nga dëmshpërblimi është e kufizuar.

Padia civile në procesin penal kërkon pjesëmarrjen aktive të personit të trafikuar në procesin ligjor, duke dhënë dëshmi gojore ose me shkrim në lidhje me shkeljen e kryer, dëmin dhe humbjen e pësuar. Në përgjithësi, kjo praktikë shkakton frikë apo ka nevojë për konsultë, prandaj ndihma ligjore falas dhe përfaqësimi janë të nevojshme për të rritur mundësitë e individit të kryejë procedurat dhe të marrë shpërblimin. Por, mungesa e një avokati kryesisht (*ex officio*), e dobëson pozitën e saj dhe sidomos, dobëson punën për informimin e viktimës në lidhje me të drejtat për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Në këtë aspekt, shoqëria civile ka një rol të padiskutueshëm. Në botë, grupet e shoqërisë civile kanë luajtur një rol themelor në zhvillimin dhe zbatimin e së drejtës të dëmshpërblimit. OJF-të dhe sindikatat kanë kryer lobim për ndryshime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ato kanë qenë dinamika e reformave në nivel kombëtar dhe kanë punuar në sigurimin e shërbimeve bazë për personat e trafikuar⁵⁷.

Mësime nga praktika

Praktika gjyqësore në lidhje me kompensimin e viktimave të trafikimit përmes padisë civile në procesin penal është e pakët. Ky fakt është bërë shkas për disa pikëpyetje që dalin në praktikë në lidhje me këtë çështje. P.sh., cili do të jetë roli i Prokurorit ose Oficerit të policisë gjyqësore në rastin e padisë civile në procesin penal? A duhet të paguajë taksën mbi aktet një viktimë e veprës penale në rastin e paraqitjes së padisë civile në procesin penal? Cili është organi shtetëror që duhet të informojë viktimën në lidhje me të drejtat e saj për të kërkuar kompensimin? A duhet të parashikohet mundësia e avokatit falas, në rastet kur viktimat ose familjarët e saj nuk kanë mjete financiare për të marrë një avokat? Si do të procedojë Gjykata për mbledhjen e provave? A ka gjykata skema apo modele për caktimin e masës së kompensimit? Këto dhe pikëpyetje të tjera shtrohen nga praktika dhe diktojnë nevojën për plotësime e përmirësime ligjore, si dhe për unifikimin e praktikës gjyqësore.

⁵⁷ *Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region*, OSCE/ODHIR, 2008, fq. 11

Në një rast të gjykuar nga Gjykata e Shkallës Parë, Tiranë, (vendim penal nr.63, dt. 23.02.2004), gjykata ka pranuar kërkesën e avokatit të viktimës së shfrytëzimit të prostitucionit për padinë civile në procesin penal. Tre gjyqtarët e trupit gjykues kanë pranuar faktin se puna e paditëses për llogari të të akuzuarit, pavarësisht se ka qenë një punë e paligjshme, duhet çmuar. Më tej trupi gjykues arsyeton se, pavarësisht se kjo punë në Shqipëri nuk ka një çmim, mund të shihen çmimet e tjera. Sidoqoftë në vendim nuk del qartë se si është vendosur shuma 2 milion lekë për shpërblimin e dëmit, pasi nuk ka asnjë referim në modele apo skema të mëparshme.

Ky vendim krijon dy debate të rëndësishme: *së pari* në lidhje me arsyetimin e tij, sipas të cilit është vlerësuar dhe është shpërblyer një punë e cila nuk njihet si e ligjshme në Shqipëri dhe *së dyti*, në lidhje me caktimin e shumës, e cila është vendosur pa pasur parasysh një skemë vlerësimi të dëmit material. Por, realisht skemë të shpërblimit të dëmit material praktika gjyqësore shqiptare nuk ka krijuar, pasi kjo praktikë është mjaft e vakët deri më sot. Për këtë nuk mund të mbahen në vëmendje edhe skema të gjykatave të vendeve të tjera, pasi në botë, nuk ka skema të unifikuara për vlerësimin e dëmit, prandaj shumat e dëmshpërblimit ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Sidoqoftë, vendimi i sipërpërmendur i gjykatës është një hap pozitiv në praktikën e mira gjyqësore. Ai është ankimuar nga i padituri civil, dhe është lënë në fuqi edhe nga gjykatat e shkallëve më të larta. Procesi i ekzekutimit ka mbetur pezull për shkak të mosparaqitjes së kreditorit për të kërkuar ekzekutimin e vendimit

Një çështje që ngrihet nga praktika gjyqësore në Shqipëri është ajo e aksesit të viktimës për të kërkuar kompensimin pavarësisht nga detyrimet financiare që ekzistojnë në procesin civil. P.sh., në një rast pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, *Gjyqtari i vetëm i gjykatës së Krimeve të Rënda ka marrë vendim për lënien e çështjes pa veprime, me qëllim plotësimin e padisë civile në procesin penal, duke i lënë kohë paditëses të paguajë taksën mbi aktet (vendimi nr. 65 akti, dt. 14.02.2008, i Gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë).*

Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë kundër vendimit të Gjyqtarit të vetëm, me arsyetimin se, ky ankim duhet të bëhej së bashku me ankimin për vendimin përfundimtar të Gjykatës. Por në lidhje me thelbin e çështjes, Gjykata e Apelit është shprehur ndryshe duke arsyetuar: *“Për faktin se gjyqtari i vetëm ka disponuar në zbatim të dispozitave të ligjit procedural civil, sheh të domosdoshme të sqarojë se instituti i “paditësit civil” i parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, normon veprimtarinë e tij në gjykimin penal, gjykim i cili i nënshtrohet rregullave procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale. Zbatimi i normave të Kodit të Procedurës Civile, rregullon gjykimin civil dhe jo atë penal”. (vendim nr. 19, dt. 20.03.2008, i Gjykatës së Apelit për krime të rënda, Tiranë).*

Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave është një tjetër çështje që has barrierë të mëdha në praktikë. Si në procesin civil edhe në rastet kur dëmshpërblimi është vendosur nga gjykata penale, i lihet vetë personit të trafikuar barra e ndjekjes së procedurave për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Këto procedura drejtohen ndaj pasurisë së trafikantit, ose shfrytëzuesit, gjë që shkakton një ndrojtje apo frikë për kreditorin. Kështu, p.sh., vendimi i sipërpërmendur i Gjykatës së Shkallës I-rë, Tiranë, *nr.63, dt. 23.02.2004*, ka marrë formën e prerë, por, nuk është vënë aspak në lëvizje Zyra e Përmbaramit për ekzekutimin e tij, pasi kreditorja nuk paraqitet, prej më shumë se dy vjetësh.

Gjithashtu, ekzekutimi i vendimit ndeshet edhe në pengesa dhe barrierë të tjera. P.sh., mund të dalin vështirësi kur trafikanti ndiqet penalisht në një vend tjetër nga ai ku ndodhet viktimja, ose kur pasuria e trafikantit ndodhet në një vend tjetër nga ai ku jepet dëmshpërblimi. Por, rasti më tipik i pengesës është ai kur pasuria nuk identifikohet tërësisht në pronësi të të pandehurit, por ndodhet e fshur në emra të tjerë ose në bashkëpronësi.

Në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore {trafikimi i personave (neni 110/a), trafikimi i femrave (114/b), trafikimi i të miturve (neni 128/b)}, zbatohet edhe ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i cili ka parashikuar një procedurë të posaçme sekuestrimi të pasurisë së të pandehurit. Në praktikën gjyqësore duket se ka një konfuzion në zbatimin e këtij ligji, në lidhje me Kodin e Procedurës Penale. Kështu p.sh., Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në vendimin e saj përfundimtar nr. 27, dt. 06.05.2008, edhe pse e ka deklaruar fajtor të pandehurin e çështjes, nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit për konfiskimin e pasurive të sekuestruara, me arsyetimin se ato duhet t’i nënshtrohen gjykimit në bazë të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Në këtë vendim, mendojmë se ka ndikuar fakti që në lidhje me pasurinë sekuestruar ishin paraqitur pretendime nga persona të tretë. Megjithatë, referimi në të ashtuquajturin ligj “antimafia” duket i paqartë, për sa ky ligj nuk krijon as gjykata dhe as procese të reja gjykimi, por i referohet gjykimeve që kryhen nga gjykatat ekzistuese. Deri tani nuk kemi raste praktike të gjykuara veçmas në bazë të ligjit kundër krimit të organizuar, porse procedurat e posaçme të parashikuara nga ky ligj, duhet të mbahen parasysh nga trupat gjykuese të Gjykatës për krime të rënda.

Kërkimi i dëmit në procesin civil

Kodi Civil parashikon kërkesën për kompensim në procesin civil, në rastin kur një person është dëmtuar në mënyrë të paligjshme. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës civile u njohet edhe të huajve.⁵⁸

Pika më e fortë e mekanizmit shtetëror përmes procesit civil është se nëpërmjet tij, viktimat e veprës penale mund të kërkojnë si dëmin material, ashtu edhe atë dëmin moral. Fakti që dëmet morale nuk janë të kërkueshme në procesin penal, përfaqëson një pengesë serioze për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit, duke pasur parasysh se në shumë raste, kërkesat e tyre adresohen për dëmin moral. Për këtë, mund t’i drejtohen vetëm gjykatës civile dhe të përballojnë problemet që lidhen me të. Kjo ka ndikuar në faktin që, në praktikën gjyqësore shqiptare, kërkesa të tilla janë pothuaj inekzistente. Sidoqoftë, nuk është faktori i vetëm, pasi mendoj se, mungon një kulturë tërësore për kërkimin e dëmit pranë organeve të drejtësisë.

E drejta për të kërkuar dëmin moral (jopasuror) ekziston në rastet si më poshtë (neni 625 i Kodit Civil):

- a. Kur personi ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij.
- b. Është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes (ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e II-të).

Kuptimi i dëmit moral është trajtuar edhe nga doktrina⁵⁹, por vendimi i sipërpërmendur unifikuës na vjen në ndihmë duke përcaktuar edhe kuptimin e dëmit moral si dhe atë të dëmit ekzistencial, si një formë e posaçme e tij.

Në lidhje me shpërblimin e dëmit moral dhe përlllogaritjen e tij, nuk ka përcaktime të posaçme të parashikuara nga Kodi Civil. Edhe praktika gjyqësore nuk ka krijuar ndonjë skemë referuese, duke e lënë vlerësimin e dëmit në çmim të gjyqtarit, rast pas rasti⁶⁰.

E drejta për të kërkuar dëmshpërblimin përmes legjislacionit të punës. Legjislacioni i punës mund të shihet si një mundësi e mirë për të kërkuar dëmshpërblimin ndaj shfrytëzuesit në rastet e shfrytëzimit për punë. Kjo mund të bazohet në Kodin e punës i cili njihet të drejtat e punës së

⁵⁸ Neni.3

⁵⁹ Shih: Marjana Tutulani, Po aty.

⁶⁰ Për më gjerë, shih Rezarta Mataj, *Disa sugjerime mbi vlerësimin sa më të drejtë të padisë: “Shpërblimi i dëmit jopasuror. Neni 608 dhe 625 i KODit Civil*, botuar në “Jeta Juridike”, nr. 2, dhjetor 2007

individit, por varet edhe në varësi të bazës dhe natyrës së kontratës së punës që ka individi, si dhe nga fakti nëse puna është e ligjshme. Gjithashtu, mekanizmat kombëtare që rregullojnë standardet e punësimit, duhet të parashikojnë garanci të afuara nga nëpunësit shtetërorë si, për shembull të drejtën e inspektorëve të punës për të ngritur padi ndaj punëdhënësve për të realizuar pagesën e dëmshpërblimit (p. sh., në rastet e mosdhënies së pagës ose të dëmtimeve në punë). Në këtë aspekt, legjislacioni ynë i punës ka nevojë për disa përmirësime, me qëllim që të sigurojë veprime mbështetëse nga palë të treta kundrejt një punëdhënësi shfrytëzues, për të ndihmuar personat e trafikuar, duke shmangur nevojën që ata ta ndjekin rastin individualisht.

Sigurimi i dëmshpërblimit përmes marrëveshjes së palëve, ose zgjidhjes në mënyrë vullnetare. Për shkak të barrierave që krijohen në proceset civile e penale për marrjen e dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar, mendoj se bëhet e këshillueshme që pagesat e dëmshpërblimit të arrihen nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare apo të ndërmjetësuar. Ato mund të ndërmjetësohen edhe nga një palë e tretë. Në këtë pikë, mund të ketë shanse më shumë zbatimimi i ligjit për ndërmjetësimin dhe zhërvjelltesimi i rolit të ndërmjetësit. Si ndërmjetës mund të jenë edhe OJF-të që mbështesin viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe sindikatat në rastet kur trafikantët janë shfrytëzues të punës së detyruar. Roli i ndërmjetësit mund të kryhet edhe nga agjentë shtetërorë. Rastet e ndërmjetësuar mund të kenë një shans më të madh për të qenë të suksesshme në pagimin e dëmshpërblimit, por kanë edhe efekt më të vogël traumatizues mbi personin e trafikuar.

4.4 SKEMA SHTETËRORE E KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

4.4. 1. Mundësia për të marrë dëmshpërblim nga fondi shtetëror.

Në Shqipëri krijohet mundësia për të siguruar një skemë shtetërore të kompensimit të viktimave të trafikimit, nëpërmjet zbatimit të ligjit, nr.9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”, ose i mbiqajtur “*ligji antimafia*”. Rëndësia e këtij ligji qëndron në parashikimin e masave të posaçme për të goditur pasurinë e krijuar si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar. Parashikimet e kodit të Procedurës Penale u konsideruan të pamjaftueshme për këtë proces. “*Nuk mund të mohohet fakti se miratimi i këtij ligji ishte rrjedhojë edhe e dështimit deri në atë kohë të legjislacionit të zakonshëm penal për të arritur rezultate të ndjeshme kundër fuqisë ekonomike të krimit të organizuar*”⁶¹.

Ligji parashikon kalimin në favor të Shtetit të të gjitha pasurive që konfiskohen me vendim gjykatë. Për administrimin e tyre krijohet “*Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*”. Por, është vetë Ministri i Financave që vendos për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, në bazë të raportit të Agjencisë dhe me këshillën e organeve vendore në të cilat ndodhet pasuria. Ndërkohë, administratori i caktuar nga gjykata gjatë fazës së sekuestrimit, ose ai i caktuar nga Agjencia në rastin e zëvendësimit të tij, kryen veprimet e nevojshme për të dërguar në llogari të Agjencisë, fondet me mjetet monetare.

Për sa më sipër, mund të evidentojmë dy shtylla kryesore të ligjit të lidhura ngushtësisht me çështjen tonë: parashikimet për veprimtarinë e organeve të drejtësisë për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe parashikimet për veprimtarinë e organeve publike për miradministrimin e fondeve të krijuara në buxhetin e shtetit nga konfiskimet e pasurive me vendimin e gjykatës, e cila ka provuar se ato kanë rrjedhur si rezultat i krimit të organizuar.

⁶¹ Ardit Mustafaj, “*Produktet e veprës penale nga këndvështrimi juridiko-penal dhe i politikës kriminale*”, Tiranë, 2007

4.4.2 A mund të përfitojnë viktimat e trafikimit nga ky ligj?

Ligji ka një vëmendje të posaçme për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar. Ai parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, tri forma të shpenzimit të pasurive të konfiskuara nga të cilat viktimat e krimit të organizuar, duke përfshirë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të përfitojnë.

Forma e parë paraqitet si dëmshpërblim individual. Ligji parashikon se mjetet monetare dhe pasuritë e paluajtshme të konfiskuara përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar (neni 33/a dhe 34/a i ligjit). Në këtë kuadër, ai autorizon administratorin që të kryejë veprimet e nevojshme dhe të dorëzojë në llogaritë e Agjencisë për Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe Konfiskuara, fondet në mjetet monetare që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave. Ndërsa, pasuritë e paluajtshme të konfiskuara shiten për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar. Por, ligji nuk është i qartë se si vendoset ky dëmshpërblim. Padyshim është gjykata që ka shqyrtuar çështjen, organi i vetëm kompetent që mund të vendosë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës në masën që ajo e çmon të arsyeshme. Por, legjislacioni shqiptar nuk parashikon mekanizma automatikë për të kryer *restitutio* ndaj viktimës që ka pësuar dëme ose urdhra kompensues të gjykatës. Prandaj është mirë që ligji të interpretohet në dy drejtime: si një mundësi për të ekzekutuar vendimet e gjykatës për shpërblimin e dëmit dhe si një mundësi për të kërkuar shpërblimin e dëmit administrativisht me skemë shtetërore. Gjykatat shqiptare janë plotësisht të afta, që në bazë të këtij ligji, të japin vendime për kompensimin e viktimave nga fondi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara mbi bazën e padisë civile në procesin penal ose të padisë civile. Por, sikurse theksuam më lart, sidomos padia civile sjell procedura të zgjatura brenda procesit civil, kurse ajo në procesin penal ka mjaft tendencë që të veçohet dhe të referohet në procesin civil. Prandaj, mendoj se është në natyrën e këtij ligji që të parashikojë mjete procedurale më të shpejta, përmes restitucionit ose kompensimit automatik nga ana e Gjykatës për viktimat e këtyre krimeve. Kjo do ta bënte goditjen ndaj krimit të organizuar më efikase. Le të mendojmë se nga dita e krijimit, deri më sot, Gjykata e Shkallës së Parë për krimet e rënda nuk ka dhënë asnjë vendim përfundimtar për kompensimin në kuadër të padisë civile në procesin penal, ndërkohë që ka sekuestruar pasuri të luajtshme e të paluajtshme për veprat e shfrytëzimit të prostitucionit apo trafikimit të të miturve.

Përdorimi i pasurisë për qëllime sociale. Këtu parashikohet kalimi i drejtpërdrejtë i pasurive të paluajtshme në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore, ku ndodhet kjo pasuri, për përmbushjen e funksioneve të tyre ose për qëllime sociale. Institucioni qendror ose njësia e qeverisjes vendore, mund ta administrojnë vetë për qëllime sociale ose t'ua japin në përdorim pa shpërblim, organizatave jofitimprurëse, enteve të tjera publike, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor, shëndetësor, të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura ose të rrezikuara nga krimi, përfshirë qendrat e asistencës dhe të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore. (neni 34 i ligjit)

Krijimi i fondit të posaçëm. Ky fond i posaçëm që krijohet, ka për qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, duke mbështetur financiarisht projekte që synojnë në përgjithësi administrimin për qëllime institucionale, sociale ose për interes publik të pasurive të paluajtshme të konfiskuara, si dhe për projekte që drejtohen konkretisht në asistencën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikut të qenieve njerëzore (neni 39 i ligjit).

4.4.3 Zbatimi i Ligjit. Strategjia kombëtare për Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka parashikuar një sërë detyrash për zbatimin e këtij ligji. Por, nga monitorimet e kryera⁶², është vënë re se, ky ligj nuk po gjen zbatimin e dëshiruar. Shtylla administrative e tij nuk ka funksionuar, ndërkohë që shtylla e organeve të drejtësisë ka funksionuar, por ka pasur edhe disa paqartësi. Mediat shpesh kanë ngritur problemin se, pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara qëndrojnë në vendet e caktuara për një kohë të gjatë pa ndonjë përkujdesje, duke u shkatërruar. Ato kanë denoncuar edhe raste kur punonjës të ngarkuar me ruajtjen e tyre kanë abuzuar me to⁶³. Pra, nuk ka pasur ndonjë rast kur ato të jenë përdorur për dëmshpërblimin e viktimave. Ministria e Financave ka qenë joaktive dhe nuk ka menaxhuar fondin e veçantë, qoftë edhe për aktivitet në favor të viktimave, apo të luftës kundër trafikut. Agjencia për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara pranë kësaj ministrie nuk funksionon, duke u justifikuar me boshllëqet ligjore për organizimin dhe kompetencat e saj, si dhe për shkak të mungesës së akteve nënligjore.

Nuk rezulton rast që dëmshpërblimi i viktimave të jetë bërë mbi bazën e ndonjë kërkesë administrative, edhe pasi vendimi i gjykatës për konfiskimin e pasurive ka marrë formë të prerë. Ndërkohë, nuk ka të dhëna të qarta nëse ka pasur raste të përdorimit në favor të viktimave të trafikut, apo rehabilitimit, a edukimit ligjor, të pasurive të krijuara nga ky fond. Qendra shtetërore për strehimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, mbahet me fonde të buxhetit të shtetit dhe nuk rezulton të kenë hyrë në këtë qendër edhe të ardhura nga Fondi i krijuar në bazë të ligjit “*antimafia*”. Nga monitorimi i vendimeve të Gjykatës për Krime të rënda 2000-2007, rezulton se ka pasur pasuri të autorëve të veprave penale të referuara nga ky ligj që janë konfiskuar dhe kanë kaluar në favor të shtetit.

Gjykata e krimeve të Rënda, në vendimet përfundimtare të saj nuk është shprehur konkretisht në lidhje me destinacionin e pasurive të konfiskuara në bazë të këtij ligji. Kjo ndodh, pasi vetë ligji nuk e ka paraqitur saktë rolin e gjykatës në këtë aspekt. Gjykata nuk ka “guxuar” të japë urdhra kompensimi në mënyrë automatike, pasi ligji bën vetëm referenca të tërthorta në këtë drejtim. Nga ana tjetër gjykata e krimeve të rënda ka qenë e paqartë edhe pas përfundimit të gjykimit, se si do të procedojë me pasuritë e sekuestruara. Sikurse theksuam në një rast, ajo nuk ka marrë vendim për konfiskimin e pasurive të sekuestruara duke referuar fatin e tyre në procedurat e ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, edhe pse është dhënë vendimi përfundimtar i saj në lidhje me gjykimin e themelit⁶⁴.

4.5 Disa përfundime e sugjerime

Në të ardhmen, kemi nevojë të vlerësojmë zbatimin e mekanizmave aktualë të të dëmshpërblimit, si dhe faktin nëse po vendoset drejtësia për personat e trafikuar. Në këtë drejtim, cilësitë më pozitive të skemave ose praktikave të vendeve të tjera mund të shërbejnë për përmirësimin e metodave ekzistuese. Modeli i restitucionit të Shteteve të Bashkuara dhe urdhrat kompensues të modelit të Mbretërisë së Bashkuar, duket të jenë mjaft të përshtatshme për Shqipërinë. Ka nevojë që ligji shqiptar të mbështesë më shumë viktimën, duke përmirësuar statusin e saj në proces, si dhe duke shmangur nevojën për të qenë vetëm viktimë, ajo që do të vërë në lëvizje të gjitha hallkat për të kërkuar dhe marrë dëmshpërblimin.

⁶² Shih: “Zhvillimi dhe zbatimi i legjislationit shqiptar, si mjet në parandalimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe garantimin e të drejtave të viktimave të tij.” Raport monitorues i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2009.

⁶³ Sipas medias elektronike “Top Chanel”, emisioni “Fiks Fare”.

⁶⁴ Vendim i Gjykatës së Shkallës së I-rë për Krimet e Rënda, nr. 27, dt. 06.05.2008,

Shërbimet këshillimore për personat e trafikuar janë një element shumë i rëndësishëm për të realizuar të drejtën e kompensimit nga viktimat. Por, në legjislacionin shqiptar nuk është parashikuar ndonjë detyrim për policinë, prokurorët apo gjyqtarët, që të informojnë viktimat e një krimi për të drejtat e tyre në procesin gjyqësor. Viktima mund të përfaqësohet nga një avokat vetëm kur paraqet padi civile në procesin penal, por nuk parashikohet një ndihmë ligjore nga shteti përmes avokatit, kryesisht. Duhet përmendur fakti se janë të lejuara organizatat e shoqërisë civile, të cilat mund të asistojnë në mënyrë vullnetare viktimën, por nuk ka ndonjë legjislacion të veçantë për të ndihmuar Organizatat Jofitimprurëse në këto raste, si dhe mbështetje shtetërore⁶⁵.

Masa të tjera duhet të merren gjithashtu, për të garantuar sigurinë fizike dhe paprekshmërinë e personave përgjatë procedurës për kërkimin e kompensimit. Kjo do të thotë që, një shtëpi e përshtatshme, ndihma sociale, këshillimet ligjore, ndihma mjekësore dhe leja e qëndrimit, janë thelbësore për të ndihmuar të drejtat përmes të cilave krijohet mundësia që të kërkohet kompensimi. Kjo ndihmë mund të lejojë një person të jetë i mbështetur mjaftueshëm, aq sa ta bëjnë atë të aftë për të paraqitur provat që mbështesin kërkesën e tij.

Kurdoherë ka probleme për personat e trafikuar, por, ato shumëfishohen në rastin e viktimave të mitura. Për shembull, procedurat ligjore janë më frikësuese për fëmijët, dhe këshillimi dhe përfaqësimi ligjor janë akoma shumë të nevojshëm që ata të kuptojnë sistemin ligjor dhe të drejtat e tyre. Ka dhe çështje të tjera të lidhura specifiku me fëmijët: nevoja për sisteme efektive të punës sociale dhe kujdestarisë për të siguruar që dhënia dhe shpenzimi i shumës së dëmshpërblimit të mund të monitorohet. Kështu fëmijët mund të mbrohen nga prindërit apo kujdestarët që nuk veprojnë në interesin e tyre më të lartë.

Një rëndësi të veçantë ka edhe hartimi i politikave mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar, bazuar në konsultime me vetë individët dhe OJF-të që përfaqësojnë interesat e tyre. P.sh., mund të parashikohen reforma ligjore dhe institucionale në fushat e legjislacionit penal, administrativ e veçanërisht atë të punës, në mënyrë që të rritet aksesin për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë dhe atyre administrative. Këtu përfshihet edhe sigurimi i asistencës ligjore për personat e trafikuar; sigurimi i informacionit dhe i shërbimeve mbështetëse; forcimi i autoritetit të inspektoriateve të punës dhe organizmave të ngjashëm për të lëshuar urdhra, përfshirë shpërblimin e dëmit; shqyrtimi i sistemeve jashtëgjyqësore për të negociuar pagesat, p.sh., ndërmjetësimi etj.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj çështjeje është edhe ekzekutimi i vendimeve dhe pagesa e dëmshpërblimit. Manuali Praktik i ODIHR-it mbi *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit* përfshin udhëzime mbi rëndësinë e dëmshpërblimit si një mënyrë për kthimin e shkeljes së të drejtave të personave të trafikuar dhe efektin e rëndësishëm restaurues dhe parandalues.⁶⁶ Në lidhje me këtë Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i OSBE-së rekomandon që shtetet duhet: të shqyrtojnë dispozita ligjore për konfiskimin e mjeteve dhe fitimeve të trafikimit dhe veprave penale të lidhura me të dhe se mjetet e konfiskuara do të përdoren në përfitim të viktimave të trafikimit.

⁶⁵ Ja si e vlerëson raporti i OSBE-ODHIR-it (Barcelonë 2007) për Shqipërinë këtë ndihmë të ofruar nga OJF-të: “Së paku një OJF, CLCI, ofron këshillime ligjore për viktimat e trafikimit, por kjo gjë nuk duket të jetë pjesë e mekanizmave të referimit në shtet. IOM ofron asistencë ligjore falas për Qendrën shtetërore të pritjes dhe NGI menaxhon një strehëz, “Diferent and Equal”. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si CLCI dhe Klinikën ligjore për të miturit. Cilësia e shërbimeve të ofruara prej tyre ka një reputacion të mirë si eksperte në këshillimet ligjore...”.

⁶⁶ *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të Drejtave të Personave të Trafikuar, Manuali Praktik* (OSBE/ODIHR, 2004), faqe 83-87.

KREU V

PËRFUNDIME DHE SYGJERIME

5.1. PËRFUNDIME DHE SYGJERIME NË LIDHJE ME LEGJISLACIONIN DHE PËRMIRËSIMIN E TIJ

Konkluzion 1: Zhvillimet më të reja në legjislacionin tonë penal janë kryer në përfaqje me aktet ndërkombëtare. P.sh., kuptimi dhe përkufizimet e trafikimit të personave, grave, të miturve në legjislacionin penal shqiptar, janë në përputhje me përkufizimet përkatëse të Protokollit të Palermos.

Rekomandime: Kodi i Procedurës Penale ka nevojë për përmirësime, pasi duhet **të sanksionohet një mbështetje më e mirë e viktimave të krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme sidomos për të sanksionuar të drejtën e tyre për informim dhe për mbrojtje ligjore.**

Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit “**Për ndihmën ligjore**” është një arritje pozitive, por që ka nevojë për shpejtësi në miratimin e akteve nënligjore, me qëllim që të shtrihet edhe në mbrojtjen e viktimave të krimeve të dhunshme. Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji do të bënte të mundur kordinimin e aktivitetit midis Organizatave Jofitimprurëse që ofrojnë asistencë për viktimat e krimeve të dhunshme dhe strukturave përgjegjëse të ngritura nga ky ligj.

Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në lidhje me rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe adresimin e nevojave të viktimave përbën vendimi i KM nr.195, datë 11.04.2007, “*Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi*”.

Në legjislacionin procedural penal nuk parashikohet *detyrimi ligjor i prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, apo ndonjë organi tjetër, për të informuar viktimat e krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme mbi të drejtat e tyre ligjore.* Masat legjislative duhet të jenë të atilla që të garantojnë për viktimën *e krimit, në mënyrë të veçantë për viktimat e krimeve të dhunshme* sigurimin e informimit ligjor qysh në momentin e kallzimit, hetimit dhe gjykimit⁶⁷.

Nevojitet përcaktimi i agjentit përgjegjës (në përgjithësi policia) për informimin e viktimave të *krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme* dhe

⁶⁷Krijimi i një liste për të strukturuar ofrimin e informacionit nga agjenti përgjegjës në përgjithësi policia:

- Unë shpërndava broshura viktimash.
- Shpjegova përmbajtjet e tyre.
- Dhashë informacion specifik.
- Dhashë informacion rreth mbështetjes për viktimat.
- Diskutova mundësinë e ndihmës me anë të mbështetjes së viktimës.
- Kontaktova për mbështetjen e viktimës në emër të viktimës.
- Dhashë numrin e regjistrimit të raportit.
- Pyeta nëse viktimat donte të informohej rreth procesit dhe vendimit për ndjekjen e tij.

përfshirja e kësaj përgjegjësie në përshkrimin e punës së agjentit përgjegjës si një detyrë formale.

Rekomandohet miratimi i strategjive efektive që përfshijnë masa konkrete të informimit të viktimave të krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme e shoqëruar me plane veprimi që përcaktojnë burime financiare për zhvillimin e aktiviteteve të orientuara nga viktimat e këtyre veprave penale.

Këto masa duhet të shoqërohen me trajnime të profesionistëve të sistemit të drejtësisë, oficerëve të policisë gjyqësore, gjyqtarëve, avokatëve, prokurorëve mbi të drejtat e viktimave të krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme.

Viktimat e krimit, në vecanti viktimat e krimeve të dhunshme duhet të gëzojnë të drejtën për të vendosur vetë në lidhje me bashkëpunimin me organet e drejtësisë, prandaj parashikimi dhe gëzimi i kësaj të drejte, shtron nevojën e ndryshimeve të mëtejshme të legjislacionit penal shqiptar.

Konkluzion 2. Legjislacioni shqiptar ka parshikuar mundësi e mjete ligjore për të kërkuar **dëmshpërblimin e viktimave të krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme.** Megjithatë, rastet në praktikë kanë qenë shumë të rralla. Prandaj është e nevojshme të përmirësohet legjislacioni shqiptar në pikat që vijojnë.

Rekomandime: Përfshirja e dispozitave të veçanta dhe specifike në **Kodin Civil** në lidhje me dëmshpërblimin për dëmin e pësuar nga shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë, shërbime të detyruara ose forma të tjera të shfrytëzimit që përbëjnë elementë të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, do të krijonte më shumë mundësi për garantimin në praktikë të drejtës për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit.

Nevojitet një përmirësim i mëtejshëm i **legjislacionit të punës**, me qëllim që të përfshijë jo vetëm një dispozitë të qartë që ndalon punën e detyruar, për mbrojtjen e të miturve dhe grave nga shfrytëzimi në punë, por edhe të vendosë sanksionet përkatëse që do ta bënin këtë dispozitë të efektshme. Standartet ndërkombëtare të punës (ILO) duhet të përbëjnë udhërrëfyes në rishikimin e Kodit të Punës.

Në kodin e Procedurës Penale duhet të bëhen të qarta detyrat e Prokurorisë në rastet e depozitimit të Padisë Civile në procesin penal për viktimat e **krimit, në mënyrë të veçantë për viktimat e krimeve të dhunshme.** Gjithashtu, ky ligj duhet të lehtësojë ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për dëmshpërblimin e viktimave të **krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme,** duke lejuar mundësinë e ekzekutimit të tyre nga një pjesë e pasurive të sekuestruara, të cilat rezultojnë të krijuara si rezultat e veprimtarive të paligjshme.

Për sa më sipër, sugjerojmë se do të kishin efekt për forcimin e dhënies së drejtësisë, parashikimi i urdhërave automatik për dëmshpërblimin, së paku për restitucionin e viktimës.

Ka mjaft rëndësi përmirësimi i legjislacionit shqiptar, veçanërisht **në legjislacionin për taksat në RSh**, me qëllim që të parashikohet përjashtimi nga taksat gjyqësore në rastin e padisë për kërkimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, veçanërisht për krimet e dhunshme. Kjo, do të siguronte rritjen e aksesit të viktimave të **krimit, në mënyrë të veçantë të viktimave të krimeve të dhunshme** për të kërkuar dëmshpërblimin nga autorët e veprave penale dhe për rrjedhojë do të forconte komponentin e dhënies së drejtësisë.

Konkluzion 3. Në lidhje me parandalimin e fenomenit të trafikimit, mendojmë se ligji nr. 9509, dt. 03.04.2006, për “**Moratoriumin për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë**” ka veprim të përkohshëm. Por, Qeveria nuk mund t’i mbështesë të gjitha përpjekjet e tij në zbatimin e këtij ligji në mënyrë të përhershme, prandaj është koha e përshtatshme për të marrë masa alternative.

Konkluzion 4. Në kuadër të forcimit të pushtetit gjyqësor, një hap të rëndësishëm përbën edhe procesi i pajisjes së Gjykatës së Krimeve të Rënda me elementët e duhur teknikë si pajisje audiovizive, kushte të vecanta për viktimat për mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme të viktimave të krimeve, në mënyrë të veçantë të viktimave të krimeve të dhunshme.

Rekomandim: Angazhimi i strukturave përkatëse për miratimin e shpejtë të akteve nën ligjore, do të kontribuonte në zbatimin më të mirë të Ligjit Nr. 9205, datë 15.03.2004, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

5.2. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME NË LIDHJE ME PROCESIN GJYQËSOR DHE PRAKTIKAT E ORGANIT TË PROCEDIMIT.

Konkluzion 1: Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, duhet të kenë një ndërgjegjësim më të mirë në lidhje me standardet ndërkombëtare në trajtimin e viktimave të **krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme**. Nevojitet të rritet niveli i njohurive dhe i zbatimit në mënyrë të drejtpërdrejtë të konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare, nga profesionistët e sistemit të drejtësisë .

Rekomandim

Rekomandohet hartimi i indeksit të të gjitha akteve ndërkombëtare universale e rajonale, me qëllim njohjen më të mirë të tyre nga profesionistët e sistemit të drejtësisë dhe zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë në praktikë.

Rekomandohet përgatitja e manualeve dhe udhëzuesve në ndihmë të organeve të gjyqësorit dhe organeve të policisë, me qëllimi që, jo vetëm të unifikohen praktikat në zbatim të legjislacionit penal, por edhe të përmirësohet trajtimi i viktimave të **krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme**, në përputhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare.

Konkluzion 2. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, duhet të kenë një ndërgjegjësime më të mirë në lidhje me standardet ndërkombëtare për dëmshpërblimin e viktimave të *krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme*. Mungesa e praktikave gjyqësore për përgjegjësinë civile të autorëve të veprave penale si dhe procedurat e tejzgjatura të procesit civil, dekurajojnë viktimën dhe rrisin rrezikun për jetën e saj nga autorët e këtyre veprave penale.

Rekomandim: Në kushtet kur ndjekja e procedurave në gjykimet civile kërkon kohë dhe kosto të caktuar, inkurajohet që viktimat të kërkojnë dëmshpërblimin nëpërmjet ngritjes së padive civile në procesin penal. Për këtë, nevojitet ndarja më e mirë e përgjegjësisë të Prokurorisë dhe Gjykatës në procesin e marrjes së provave dhe të të provuarit të dëmit. Detyra të qarta duhet të kenë edhe oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me trajtimin e viktimave.

Për këtë është mirë të ketë guida dhe skema për përllogaritjen e dëmit.

Mendojmë se gjatë procesit, viktimat e *krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme* të pyetet nga gjyqtari, prokurori, psikologu, një përfaqësues i organizatës jofitimprurëse që ofron shërbime për viktimën dhe, jo nga avokati i autorit të veprës penale. Gjatë monitorimit u konstatua se asistencë me psikolog për viktimat e *krimit, në mënyrë të veçantë për viktimat e krimeve të dhunshme* mbetet rastësore, nuk ka një praktikë të vijueshme.

Rekomandohet të krijohet një praktikë e unifikuar e mbështetjes psikologjike gjatë hetimit e gjykimin, jo vetëm në rastet kur viktimat e *krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme* janë të mitura, por në çdo rast tjetër gjykimi.

-Nevojitet rritja e kapaciteteve të stafëve që punojnë në komponentin e ndihmës ligjore e psiko-sociale në ndihmë të viktimave të *krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme*, me qëllim identifikimin e viktimave dhe të rasteve në kohë, mbështetjen e tyre dhe sigurimin e zgjidhjeve të duhura, duke përdorur mjetet ligjore. Këta aktorë që merren me adresimin e këtij fenomeni mund të jenë shtetërorë ose jo shtetërorë, sidoqoftë nevojitet kualifikimi i tyre i lartë.

-Është e nevojshme të ketë një bashkëpunim më të mirë në formën e rrjetit midis institucionit të policisë, organit të akuzës, gjyqësorit dhe organizatave që ofrojnë shërbime për këto viktimat. Në këtë kuadër duhet të përfshihet edhe unifikimi i statistikave. Rekomandohet unifikimi i statistikave midis institucionit të policisë, organit të akuzës, gjyqësorit dhe organizatave që ofrojnë shërbime për këto viktimat.

Rekomandohet organizmi i trajnimeve nga strukturat përkatëse (Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Avokatisë në bashkëpunim me Organizatat Jofitimprurëse, etj) për profesionistët e sistemit të drejtësisë me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.

5.3. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME NË LIDHJE ME ROLIN E NGO-VE

Organizatat Jofitimprurëse kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, këshillimeve ligjore dhe psikosociale, akomodimit për viktimat, sigurinë fizike të tyre, përfaqësimit të çështjeve gjyqësore në gjykatat e niveleve të ndryshme, etj.

Këto Organizata Jofitimprurëse kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në lobimin për përmirësime të kuadrit ligjor në përjasje me standartet ndërkombëtare me synimin që sistemi i drejtësisë të ketë në qendër të vëmendjes jo vetëm goditjen e këtyre veprave penale por edhe një vëmendje të veçantë mbi të drejtat e viktimave të ***krimit, në mënyrë të veçantë viktimave të krimeve të dhunshme***.

Gjatë viteve të fundit ka pasur një bashkëpunim të mirë të Kordinatores Kombëtare mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me Organizatat Jofitimprurëse që punojnë për adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore, i cili ka konsistuar në një punë të përbashkët të kordinuar dhe institucionalizuar me synim parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen e viktimave dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Roli i NGO që punojnë në fushën e mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore duhet të forcohet jo vetëm përmes rritjes së kapaciteteve të tyre por edhe nëpërmjet një mbështetje të vazhdueshme nga ana e shtetit, duke i konsideruar ato aktorë të rëndësishëm.

Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit të Organizatave Jofitimprurëse që punojnë për adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore me aktorët shtetërorë përkatës për parandalimin e këtij fenomeni. Në këtë kuadr nevojitet hartimi dhe zbatimi i politikave që përfshijnë masa gjithëpërfshirëse me qëllim mbrojtjen e të drejtave kryesore social ekonomike të grave dhe grupeve të tjera në nevojë, të drejtës për arsim, të drejtës për punësim, të drejtës për të pasur një shtëpi dhe shërbime të tjera mbështetëse. Garantimi i këtyre të drejtave do të forconte grupet në rrisht trafikimi dhe do të bënte më pak vulnerabël ndaj fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Rekomandohet parashikimi për ndërhyrjen e OJF-ve si palë e tretë në gjykim, me qëllim që të jenë një mbështetje më e mirë për viktimat e ***krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme***, të cilat, rregullisht i shmangen përballjes, por nuk kanë as të drejtën të përfaqësohen me avokat dhe mbeten vetëm në pozitën e dëshmitares.

5.4. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME NË LIDHJE ME DËMSHPËRBLIMIN DHE REHABILITIMIN E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

Është e nevojshme që gjithë përvoja juridike shqiptare të synojë përmirësimin e standardeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë se viktimat e ***krimit, në mënyrë të veçantë viktimat e krimeve të dhunshme*** duhet të gëzojnë të drejtën e kompensimit të

dëmit nga keqbërësi ose shteti, duke e konsideruar ushtrimin e kësaj të drejte me rëndësi të veçantë, jo vetëm për rehabilitimin fizik, psikologjik dhe shoqëror të viktimës, por edhe për vetë forcën e drejtësisë.

Ligji Nr.9284, datë 30.09.2004 “***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar***” ; Krijimi i një bordi, i cili do të vendoste ndarjen e aseteve për qëllime sociale, për qeverisjen vendore, për agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe për kompensimin e viktimës deri në 40% të aseteve të konfiskuara, përbën aktualisht një arritje pozitive që duhet vënë në zbatim. Kjo përbën një nga prioritetet e Qeverisë dhe Kordinatores Kombëtare, por ende nuk funksionon në praktikë detyrimi i vendosur nga ligji.

Masa të tjera duhet të merren gjithashtu, për të garantuar sigurinë fizike dhe paprekshmërinë e viktimave përgjatë procedurës për kërkimin e kompensimit. Kjo do të thotë që, një shtëpi e përshtatshme, ndihma sociale, këshillime ligjore, ndihmë mjekësore dhe leja e qëndrimit, janë thelbësore për të ndihmuar të drejtat përmes të cilave krijohet mundësia që të kërkohet kompensimi. Kjo ndihmë duhet të jetë e asaj shkalle sa të lejojë që një person të jetë i mbështetur mjaftueshëm, sa ta bëjnë atë të aftë për të paraqitur provat që mbështesin kërkesën e tij.

Bibliografi:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8417, datë 21.10.1998

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.

- Protokoll “Kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

- Protokoll “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe femijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002.

- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW, 1979, ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 09.11.1993.

-Konventa Europiane “Për Kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, ratifikuar me ligjin nr.9265, datë 29.07.2004.

Konventa ndërkombëtare për ndalimin e trafikut të grave dhe fëmijëve, përfunduar në Gjenevë, më 1921 dhe protokoll i amendues i saj.

- Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshë madhore, përfunduar në Gjenevë më 1933 dhe protokoll i amendues i saj.

- Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të tjerëve dhe protokoll final i saj në 1950.

-Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, Ratifikuar me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006.

“Deklarata e parimeve bazë të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit”

Direktiva e Këshillit të BE-së “Për kompensimin e viktimave të krimit”

Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së për Paraqitjen e Viktimave në Proceset Penale

Vendimi kuadër i 2002, mbi trafikimin e qënieve njerëzore, mbi elementët e ndjekjes penale të trafikimit të qënieve njerëzore.

Vendimi kuadër i 2003 mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve dhe pornografisë.

Direktiva e 2004 mbi lejen e qëndrimit për viktimat që bashkëpunojnë me autoritetet

Komiteti CEDAW, rekomandimet e janarit të vitit 2003.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, ndryshuar me ligjin nr.8204, datë 10.04.1997, ndryshuar me ligjin nr.8279, datë 15.01.1998, ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, ndryshuar me ligjin nr.9017, datë 06.03.2003, ndryshuar me ligjin nr.9030, datë 13.03.2003, ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.02.2004.

Kodi i Procedurës Penale, Ligji nr.7905, datë 21.03.1995, ndryshuar me ligjin nr.8460, datë 11.02.1999; me ligjin nr.8570, datë 20.01.2000; me ligjin 8602, datë 10.04.2000 dhe ligjin 8813, datë 13.06.2002.

Kodi Civil, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.07.1994

Kodi i Familjes, Ligji nr.9062, datë 08.05.2003

Kodi i Punës, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996, ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.07.2003.

Ligji Nr.9110, datë 24.07.2003, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”*

Ligji Nr.9284, datë 30.09.2004 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”*

Ligji nr. 9205, datë 15.03.2004 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*.

Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*.

Ligji nr. 9509, dt. 03.04.2006, për *“Moratoriumin për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë”*.

Ligji Nr.9381, dt.28.04.2005 *“Për kompensimin e burgimit të padrejtë”*

Ligji nr.10039, datë 22.12.2008, *“Për ndihmën juridike”*

Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr.207, datë 29.05.2002, *“Për përcaktimin e punëve të vështira dhe të rrezikshme”*;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.205, datë 09.05.2002 *“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 384, datë 20.05.1996 “Për mbrojtjen e të miturve në punë”*.

Vendimi i Këshillit të Ministrave **nr.195, datë 11.04.2007**, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”

Vendimi i Këshillit të Ministrave **Nr.632, dt.18.09.2003** “Për nxitjen e punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”

Urdhëri Nr.645, datë 20.03.2006, i MPÇSSHB “Për prioritetet e programit të nxitjes së punësimit për vitin 2006”

Urdhëri i Përbashkët i Ministrave, miratuar nga Ministri i Brendshëm me nr.3394/4, datë 17.05.2006, nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.1192, datë 19.05.2006 dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme me nr.7590, datë 24.05.2006

Strategjia Kombëtare e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, plani i veprimit të kësaj strategjie miratuar me Urdhërin e kryeministrit Nr.25, datë 22.02.2005. Strategjia kombëtare dhe plani i punës për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikimit 2004-2006

“Kudri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit 2005-2007”

Koordinatorja Kombëtare mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore “Prioritetet afat shkurtër për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe disa nga arritjet kryesore në 2006”

Njesia Antitrafik, Ministria e Brendshme, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”, *Mars 2007*.

Njesia Antitrafik, Ministria e Brendshme, “Raporti për realizimin e strategjisë kombëtare shqiptare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Janar – Dhjetor 2006”

Raporti i OSBE-ODHIR-it, “Kompensimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, 2008.

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në Strasburg

Vendimi Unifikues, nr. 12, dt. 14.09.2007, i kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë

Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (nr. 284, dt. 15. 09. 2000)

Vendimi nr.03, datë 16.01.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Vendimi nr.29, datë 06.10.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vendimi nr.68, datë 15.12.2005, Vendimi nr.3, datë 28.04.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vendimi nr.29, datë 11.06.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vendimi nr.03, datë 16.01.2007, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vendimi 09, datë 12.02.2007 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Vendim i Gjykatës së Shkallës I-rë për krime të rënda, Nr. 65 Akti, dt. 14.02.2008